



264/18, 268/18, 279/18, 283/18  
291/18



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	<b><u>Menaxheri i Prokurimit – Komuna e Gjakovës</u></b> OE. “Pe-Vla-Ku” & “Joos Krasniqi Baze” OE. “Euroasfalt” OE. “Mirusha Company” OE. “Drini Company” OE. “Kag Asphalt Company”	Kopje:	<b>Paneli Shqyrtues - OSHP</b>
Prej:	Xhevdet Bushi – Ekspert i jashtëm shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	<b>Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me: Nr.264/18; 268/18; 279/18; 283/18 &amp; 291/18</b>		
Datë	13.07. 2018		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i qarkores së Gjakovës**” llot I me nr. të prokurimit: **632-18-843-511**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Gjakovës**.

Lidhur me ankesën e dt: 13.06.2018 me nr. **264/18** të parashtruar nga OE. “**Pe-Vla-Ku**” & “**Joos&Krasniqi Bazë**” -

Lidhur me ankesën e dt: 14.06.2018 me nr. **268/18** të parashtruar nga OE “**EUROASPHALT**”- Gjakovë.

Lidhur me ankesën e dt: 20.06.2018 me nr. **279/18** të parashtruar nga OE “**Mirusha Company**”- Klinë.

Lidhur me ankesën e dt: 21.06.2018 me nr. **283/18** të parashtruar nga OE “**Drini Company**”- Prizren.

Lidhur me ankesën e dt: 22.06.2018 me nr. **291/18** të parashtruar nga OE “**Kag Asphalt Company**”- Prizren.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

**Ti dorëzohet:**

- Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues: 264/18;268/18;279/18;283/18 dhe 291/18

**Raporti i ekspertit shqyrtues**, lidhur me ankesën e parashtruar 264/18;268/18;279/18;283/18 dhe 291/18, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i Qarkores se Gjakoves**” llot I me nr. të prokurimit: **632-18-843-511**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Gjakovës**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPEERTIT SHQYRTUES**

		<b>26.06.2018</b>	<b>13.07.2018</b>
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>		<i>data e autorizimit të ekspertit.</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

- 1). Me datën: 13.06.2018 nga OE “Pe-Vla-Ku” & “Joos& Krasniqi Bazë” - Prishtinë,
- 2). Me datën: 14.06.2018 nga OE. “EUROASPHALT”- Gjakovë,
- 3). Me datën: 20.06.2018 nga OE “Mirusha Company”- Klinë.
- 4) Me datën : 21.06.2018 nga OE “Drini Company”- Prizren.
- 5) Me datën : 22.06.2018 nga OE “Kag Asphalt Company”- Prizren.

Kanë parashtruar ankesë në OSHP , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “4 A-M”-Shqipëri, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i Qarkores se Gjakoves” Ilot I me nr. të prokurimit: 632-18-843-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**Operatori Ekonomik Ankues “Pe-Vla-Ku” & “Joos&Krasniqi Bazë” – Prishtinë Ankesa nr. 264/18**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Pe-Vla-Ku” & “Joos&Krasniqi Bazë” - Prishtinë, janë:

**Neni 1 ; Neni 7 ; Neni 56; .Neni 59 pika 1,2 &4 dhe Neni 60**

## DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Gjatë procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktues në këtë rast – Komuna e Gjakovës, ka bërë shkeljen e Ligjit të prokurimit publik, përkatësisht nëse të lartëcekura duke devijuar nga kriteret e perzgjedhjes të vendosura në dosjen e tenderit...

Me rastin e rekoamdnimit për dhënie të kontratës është shkelur rëndë LPP-ja me nr.04/L-042, e plotësuar dhe ndryshuar me LPP nr.04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-092.

Duke shkelur nenin 1,7,10 pika 3 dhe 5, neni 56,59 pika 1,2,4, neni 60,61 pika 2,2.1,2.2,2.3, neni 70.

Ku konkretisht në **nenin 59 paragrafi 4 thuhet**: “Autoriteti Kontraktues të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit”, pavarësisht nga e mëparshmja Autoriteti kontraktues mund të konsideroj një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet aq sa është e mundur dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ndërsa neni 60 paragrafi 1, Autoriteti Kontraktues do ti jep kontratën publike Operatorit Ekonomik që ka dorëzuar 1.1 Tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët.

**Koncerziumi “PE-VLA-KU” shpk & “JOOS&Krasniqi-Bazë” shpk, kërkojnë nga OSHP-ja që të bëjë hapjen e kopjes së tenderit tonë në prezencën tonë. Dosja jonë është manipuluar.**

**Arsyetimi nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës për eliminim është i pabazë.**

**Ne i bëjmë me dije OSHP-ne se në ofertën tonë kemi vënë numra si 0001/1147, 0002/1147,...1147/1147, pasi që kemi pasur qasje në dokumente kemi parë se dosja jonë është manipuluar.**

- **Sa i përket Operatorit Ekonomik të rekoamnduar për dhënie të kontratës “4AM” shpk, ai është i papërgjegjshëm. Me qasjen tonë kemi vërejtur se:**

**1. “4 AM” shpk** ka bërë marrëveshje për furnizim me rërë dhe zhavorr me kompanin “DREONI” shpk, kompani të cilës i ka skaduar afati i licencës.

**2. “4 AM” shpk** ka bërë marrëveshje për furnizim me beton me kompanin “BENITA COMPANY” shpk, kompani poashtu të cilës i ka skaduar afati i licencës.

Kompania e rekomanduar për dhënie të kontratës “4 AM” shpk, gjithashtu ka ofruar licencën e auditorit me dy data të cilat nuk përputhen njëra me tjetrën.

Të gjitha këto konstatime dhe prova të lartëcekura vërtetojnë se AK në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të lartëcekura të LPP-së.

Nga të cekurat më lartë i propozojnë OSHP-së që ankesën tonë ta aprovoj të bazuar dhe të kthej lëndën në Rivlerësim.

Në rast të ndonjë paqartësie ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni me qëllim të qartësimit të kërkesës sonë.

### Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	.....28.02.2018
Lloji i procedurës së aplikuar:	.....Procedurë e hapjes së tenderit
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	.....Kontratë Pune, Vlera e madhe – 24 m
Vlera e parashikuar e kontratës:	.....8,000,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52):	.....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	10.04.2018 ora 12:00
Data e hapjes së ofertave.....	10.04.2018 ora 12:00
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	29.05.2018
Data e njoftimit me letër standarde për tenderues të eliminuar .....	29.05.2018
Data e njoftimit për dhënien e kontratës:.....	01.06.2018
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	06.06.2018
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	12.06.2018

## Operatori Ekonomik Ankues “Euroasphalt” shpk – Gjakovë – Ankesa nr.268/18

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Euroasphalt” shpk - Gjakovë, janë:

**Neni 1 – Qellimi (LPP) ;**  
**Neni 6 - Ekonomia dhe efikasiteti (LPP);**  
**Neni 7 – Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi (LPP);**  
**Neni 56 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi (LPP);**  
**Neni 72 – Dokumentet dhe informacionet shpesh (LPP)**  
**Neni 39 – Sqarimi i Tenderëve (RrUOPP)**  
**Neni 43 – Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve (RrUOPP)**

### DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Supozohet se AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, përshkak se nuk i ka përdorë fondet publike në mënyrë ekonomike, sepse kompania jonë sipas procesverbalit të hapjes së ofertave ka qenë më e lirë se OE i rekomanduar për kontratë në shumë prej 450,643.13 €, me çrast AK ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pra Autoriteti Kontraktues është dashur të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera.

Par.1 dhe 2 i Nenit 6 të LPP-së cek:

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Oferta jonë refuzohet dhe ne eliminohejmë për një lëshim gjuhësor nga ana e shpeditit gjatë përgatitjes së DUD-it doganor me rastin e importit të makinerive përkatëse (Eskavatorëve përkatësisht bagerave, soq i ka emërtuar shpediti ynë).

**PROVË:** Gjenerali i bashkangjitur dëshmitë se kompania jonë i posedon DUD-at doganor për të njëjtat pajisje të kërkuara sipas FDT-së pozicioni 9.1& 9.2 pika a) tek lista e mjeteve të punës/pajisjet teknike.

Pra, te FDT Autoriteti Kontraktues te pozicioni 9.2 ka kërkuar që të ofroj dëshmi se ka në dispozicion sipas pikës **a) eskavator me peshë totale min.13 Ton** duhet qartësuar për Autoritetin tuaj se ne si ofertues kemi dëshmuar se posedojmë pajisjet e lartëcekura me dëshmitë e bashkangjitura (DUD-at doganor) dhe foto dëshmitë për të njëjtat, pasi që janë eskavatorë në fjalë.

DUD-i 1# Eskavatori nr.1 Termi (Bager i përdorur), Marka : Katerpillar, Tipi 318 BL nr.serik

CAT0318BCADCO1352 (bashkangjitur gjeni edhe fotot), pra shihen dhe është dëshmuar poashtu me foto se në rastin e njejte kemi te bejme me eskavator mirepo përshkrimi në DUD-a nga formulimi i shpediterit është më shumë në shprehin popullore dhe është prezantuar si “Bager” edhe pse nje pajisje e tillë është eskavator.

DUD-i 2# Eskavatori. Nr.2 Termi (Bager i perdorur), Marka FURAKAËA , Tipi 3665, nr.serik 382F0703 (Bashkangjitur gjeni edhe fotot), pra shihet dhe është dëshmuar poashtu me foto se në rastin konkret kemi të bëjmë me eskavator mirepo përshkrimi nga DUD-at nga formulimi i shpediterit është më shumë në shprehin popullor dhe është prezantuar si “Bager” dhe pse një pajisje e tillë është “eskavator”.

DUD-i 2# - Eskavator nr.2: Termi (bager i përdorur), Marka FURAKAËA, Tipi: 365, Nr.serik: 382F0703 (bashkangjitur gjeni edhe foton), pra shihet dhe është dëshmuar poashtu me foto se në rastin në fjalë kemi të bëjmë me eskavator mirëpo përshkrimi ne DUD nga formulimi i shpediterit është shumë në shprehin popullore dhe është prezantuar si “bager” edhe pse një pasjisje e tillë është “eskavator”.

Fatura Tatimore # - Eskavatori Nr.3: Termi (eskavator-bager i përdorur)< Marka: CAT, Tipi: M318 (bashkangjitur gjeni edhe fotot), pra shihet dhe është dëshmuar poashtu me foto se në rastin në fjalë kemi të bëjmë me eskavator, mirëpo përshkrimi është në eskavator dhe bager i përdorur me që shitësi NTP. “FETOSHI” SHPK sigurishtë që ka bërë përshkrimin në faturë duke u bazuar në DUD-in doganor që ka poseduar, ça na jep të kuptojmë në raste të tilla me përshkrim jo korrekt gjuhësor kanë pasur edhe kompani/importues të tjerë anekënd Kosovës si rasti ynë në fjalë.

Fatura Tatimore # - Eskavatori Nr.4: Termi (eskavator), Marka: ATLAS 1400 (bashkangjitur gjeni edhe fotot) në këtë rast shohim se shitësi kompania NPT. “NOLI” ka bërë përshkrimin paksa më të saktë se në rastet e lartëcekura.

Me këto që thamë dhe sqaruam më lartë dhe dëshmuam me dokumentet e pronësisë dhe foto dëshmitë se i posedojmë 4 eskavator që AK i ka kërkuar sipas FDT-së.

Për autoritetin tuaj duam të sqarojmë se ne kemi tentuar që të mbledhim dëshmi dhe fakte tjera që lëshime të tilla gjuhësore kemi pasur edhe te kompanitë e tjera ofertuese si psh. NTSN. “ARFA” ku DUD-at e prezantuar në ofertën e tij shohim se kemi eskavator të cilët janë dëshmuar në DUD me përshkrimin Bager(gropues) i përdorur, Marka:CAT, Tipi 322 NL, ku shihet se kemi të bëjmë me eskavator, e që termin e ka edhe ky Bager, poashtu kemi pajisjen e dytë tek i njëjti ofertues ku DUD-i doganor ka përshkrimin : Bager(lugë ngarkuese) i përdorur, Marka: HANOMAG, Tipi: 660, pra edhe te ky rast shohim se kemi të bëjmë me një eskavator dhe një lugë ngarkuese MIRËPO gjatë importit dhe zhvillimit të procedurave doganore shpediteri përkatës ka bërë të njëjtin gabim dhe e ka përdorur këtë term pra Bager pavarësisht llojit të makinerisë e cila është importuar, andaj ftojme edhe autoritetin tuaj që nëse është e nevojshme ta verifikoj dhe kërkojë informata shtesë nga autoriteti doganor (Dogana e Kosovës).

Për ta sqaruar më mirë edhe për ekspertin edhe për panelin shqyrtues termi “bager – Eskavator”, ne kemi bërë një hulumtim në internet se pajisjen për të cilën po flasim në disa gjuhë botërore, fjala eskavator përdoret si bager në gjuhën serbe, gjermane ...etj.

Fjala Bager nëse e kërkojmë në [www.Google.com](http://www.Google.com) na del eskavatori, pra është e njëjtë fjala dhe ka të njëjtin kuptim.

PROVË: Dëshmi nga hulumtimi i bërë në internet, disa faqe nga kërkuesi botëror “GOOGLE”.

Supozojmë se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së sepse AK nuk i ka trajtuar OE-të në mënyrë të barabartë, sepse në disa raste tek disa OE ka pranuar dhe lejuar devijime tjera, tek operatori i rekomanduar për kontratë,

kurse tek kompania jonë në disa gabime tekstuale, me çrast na eliminon duke përdorur “Standarde të dyfishta”.

Tek raporti i vlerësimit të tenderëve AK ka shpallur vetëm dy prej njëzetë e tre ofertuesve si operator të përgjegjshëm, mirëpo pas qasjes së dokumenteve që kemi pasur me datën 05.06.2018, kemi vërejtje se OE i rekomanduar për kontratë del i papërgjegjshëm ku më poshtë do ti cekim disa pika.

AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk e ka marr parasysh pikën nenin 27 tek dosja e tenderit – Ekzaminimi i Tenderëve ku shënohet:

27.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas kërkesave të parashtruara në këtë dosje të tenderit.

27.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

- a) është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b) është në pajtueshmëri me termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;
- c) është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosje të tenderit.

41.6 Të qenët “në pajtueshmëri” nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosjen e tenderit duke mos u larguar substancialisht nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

“Largime dhe kufizime substanciale” janë ato të cilat:

- (i) Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit; dhe /ose
- (ii) Afektojnë parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës; dhe/ose
- (iii) Kufizon të drejtën e AK ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës; dhe/ose
- (iv) Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat.

Përderisa një devijim i tenderit nga kërkesat e specifikuara dhe specifikimet nuk do të thotë trajtim i pabarabartë i ofertuesve, nëse tenderi i tillë është pranuar, dhe ka vetëm ndikim të papërfillshëm në konkurrencën e lirë dhe të ndershme në mes tyre, devijimi i tillë nuk do të konsiderohet si “i konsiderueshëm”.

Supozohet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së sepse:

1. Paramasës – Listës së çmimeve, pothuaj tek pjesa më e madhe e tabelave i mungon valuta tek shumat e vendosura nga OE i rekomanduar për kontratë, pra nuk është cekur valuta € tëk pozicionet.

Në nenin 12 të LPP-së thuhet se: Të gjitha çmimet dhe vlerat e specifikuara në çfarëdo kontrate publike, dosje të tenderit, njoftim, ftesë për tender ose pjesëmarrje, duhet të deklarohen dhe të gjitha pagesat e tyre duhet të bëhen në EURO, poashtu tek pozicioni 20.1 i dosjes së tenderit thuhet se: Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€).

Pra, në këtë rast OE. “4 AM” SHPK nuk ka shënuar tek njësit/pozicionet valutën e çmimeve të ofruara.

Duke marr parasysh se OE fitues është nga Shqipëria, supozojmë se çmimet ka mundur ti jap në valutën e shtetit të tij në ALL (Lekë).

- 2.OE “4 AM” SHPK me seli në Shqipëri nuk ka prezantuar dokumentet si në vijim sipas kërkesave të AK-së:
- Certifikata e numrit fiskal,
  - Certifikata e TVSH-së

Nëse këto këto dokumente nuk jepen në vendin e tyre të themelimit, ky OE është dashur që të jap një deklaratë dhe të tregoj se dokumentet e tilla nuk lëshohen dhe nuk ekzistojnë si të tilla në vendin e tyre të themelimit.

OE. “4 AM” SHPK ka prezantuar vetëm certifikatën e regjistrimit, një licencë dhe një ekstrakt historik, mirëpo nuk ka asnjë dokument si “Deklaratë” për këto dy dokumente .

AK ka cekur se këto dokumente përfshihen në një dokument tek OE fitues i cili është nga Shqipëria, mirëpo nuk ka prezantuar prova se diku aty apo cekën fjalët Nr.fiskal dhe TVSH.

3. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar licencat/lejet e lëshuara nga KPMM-ja si dhe marrëveshjet/kontratë të lidhur me ndërmarrjet e licensuara për rërë dhe zhavore, me material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë të asfaltit mirëpo pas qasjes së këtij operatori kemi vërejtur se:

- Marrëveshja apo kontrata e nënshkruar në mes të “BES Group” e shndërruar nga ish “AHN Group” iu është bashkangjitur licenca nga KPMM-ja për bazën e asfaltit.
- Me tu shndërruar ky biznes nga “AHN Group” në “BES Group” është dashur që edhe licensa e cila është dhënë në shfrytëzim “AHN Group”-it të transferohet në “BES Group” gjithmonë duke u rrespektuar procedurat ligjore të KPMM-së , sepse licensa i është dhënë në shfrytëzim “AHN Group”-it dhe jo “BES Group”-it, sepse edhe nr.biznesit gjatë shndërrimit/ndryshimit të emrit të kompanisë ndryshojnë po edhe nr.fiskal, tvsh etj.

PROVË: Vendimi shpjegues Nr.02/2016 i ATK-së (Për procedurat për tyransferimin e pronësisë tek ndryshimi në formën e biznesit).

<http://ëëë.atk-ks.org/ëp-content/upload/2017/08/Shqip-VSHP-2-2016-PROCEDURAT-P%C3%8BR-TRANSFERIMIN-E-PRON%C3%8BSIS%8B-TEK-NDRYSHIMI-N%C3%8B-FORM%C3%8BN-E-BIZNESIT.pdf>

në faqen nr.4 të këtij VENDIMI shpjegues jepet edhe forma e certifikatës së re të biznesit se si ndryshon nr.biznesit dhe nr.fiskal si dhe përfundi numrave të re ekziston nr.vjetër.

andaj duke pasur parasysh se kanë ndryshuar numrat e biznesit, fiska dhe tvsh, ky OE “AHN-Group” është dashur që të bëjë aplikim për ndryshimin e merit tek licenca që e posedon në KPMM duke plotësuar formën e më poshtme ([shih linkun](#)), dhe ju fare lehtë mund ta verifikoni se a ka licencë kompania “BES Group” për bazën e asfaltit, sepse OE i rekomanduar për kontratë ka kontratë me “BES Group” dhe jo me kompaninë “AHN-Group”.

<https://kosovo-mining.org/ëp-content/uploads/2017/09/Aplikacioni-per-Transfer-Licence-shq.pdf>

Dokumenti i kërkuar në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163, Neni 10.2 si dhe nenit 7 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet thotë:

Nëse bartësi i licencës për Hulumtimin ose licencën për shfrytëzim, bartësi i një leje dëshiron të bëjë bartjen e

licencës ose lejes në fjalë, Bartësi i kësaj licence ose Leje dhe pranuesi i propozuar i saj duhet që bashkrisht të dorëzoj në KPMM një kërkesë të plotësuar në formën e paraparë së bashku me taksën e paraparë, si dhe ti bashkangjiten disa dokumente e që mund ti gjeni në linkun e lartëshënuar në faqe 3 dhe 4.

Çdo propozim për ndryshimin e një pronari të Rëndësishëm të një bartësi të Licencës ose Lejet **duhet të miratohet nga KPMM-ja**. KPMM mund ta refuzojë miratimin e ndryshimit nëse pronari i ri i rëndësishëm nuk i përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në nën-paragrafin 1.2 paragrafi 1 të nenit 6 të këtij ligji ose nëse ndryshimi i propozuar do të rezultojë në humbjen e të drejtave të Bartësit të Licencës ose Lejes sipas cilësdo dispozitë tjetër të nenit 6 të këtij ligji.

Pra kompania “AHN Group” tani “BES Group” nuk e ka bërë transferimin e licencës në emrin e ri të kompanisë, poashtu kjo kompani tani më në lokacionin ku e ka pasur bazën e asfaltit më nuk ekziston më, dhe kjo mund të verifikohet nga AK, pra kemi të bëjmë me një kompani e cila ka mbështet OE e rekomanduar për kontratë që nuk është aktive tash e disa vite, si dhe nuk ka përmbush aspak procedurat ligjore, lidhur me bartjen e licencës (kalimi nga AHN Group në BES Group).

Poashtu marrëveshjet e nënshkruara në mes të OE. “4 AM” dhe kompanieve “DREONI”, “Benita Company” dhe “BES Group” për furnizim me: rërë, zhavorre, material nga gurorët dhe asfalt beton, nuk e kanë afatin prej 180 ditë që këto marrëveshje duhet të jenë valide sa edhe zgjatë kontrata, andaj përderisa nuk e kanë këtë periudhë kohore si validitet, këto dokumente nuk mund të merren si valide.

PROVË: Licenca e skaduar dhe marrëveshjet/kontratat me këta operator.

4.OE.”4 AM” i rekomanduar për kontratë ka prezantuar raportet e auditimit/ pasqyrat financiare për tri vitet e fundit, mirëpo si dëshmi **nuk ka prezantuar kopjen e noterizuar të licencës së kompanisë** e cila ia ka kryer auditimet, ky OE thjeshtë ia ka bashkangjitur vetes certifikatën e biznesit të kompanisë audituese, mirëpo jo edhe licencën e cila ka qenë kërkesë e AK-së, OE ka vendosur si duket një licencë personale e jo të kompanisë, sepse auditimet janë bërë nga kompania.

5. Poashtu OE i rekoamnduar për kontratë nuk ka arritur ta dëshmojë qarkullimin financiar “bankar” me një vlerë prej 7,000,000 € (shtatë milion euro) për tri vitet e fundit, ku si dëshmi është kërkuar raport bankar i nënshkruar dhe i vulosur për periudhën e tri viteve të fundit.

OE. “4 AM” ka vendosur një dokument vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e shërbimit të tatimpaguesve të Republikës së Shqipërisë. Ky dokument përsëri nuk ka valutën EURO (€) mirëpo ka valutën LEKË (ALL) e cila valutë nuk është e lejueshme sipas Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, pra ky dokument është në kundërshtim me kërkesën e AK-së, pasi që nuk është **“Raport bankar” por është vërtetim.**

PROVË: Dokumenti i bashkangjitur.

AK në përgjigjen e dhënë në vendimin për rishqyrtim ka thënë që ka vërtetim bankar, mirëpo në dosje që na është dhënë gjatë qasjes në dokumente publike nuk kemi arrit të gjejmë askund.

6. Inxhinieri i vendosur në listën e OE. “4 AM” Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë i kërkuar të drejtimit konstruktiv apo infrastrukturë rrugore, nuk është askund me personin që e ka vendosur “Bujar Kurti”, pasi që drejtimi i këtij inxhinieri është inxhinier për ndërtime industriale – ura e që nuk është e njëjtë ashtu sic është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.



7. Sa i përket makinerisë mjeteve – pajisjeve teknike për realizimin e kontratës në fjalë OE i rekomanduar për kontratë “4 AM” nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme lidhur me:

-Katër (4) eskavator me peshë totale prej min 13 T, nuk ka dëshmi dhe dokumentacion të pastër që dëshmon, pra edhe pas shiqimit të dokumenteve dhe verifikimit të këtyre pajisjeve/mjeteve kemi hulumtuar në internet dhe kemi vërtetuar se disa prej këtyre mjeteve nuk kanë mundësi të peshës min. 13 T,

-Gjashtë (6) kamionët e prezantuar nuk ka dëshmi të mjaftueshme se kanë konstruksion-ndërtim kiper ashtu sic është kërkuar në dosjen e tenderit,

-Dy (2) kamionët e prezantuar nuk kanë dëshmi të mjaftueshme se kanë konstruksion-ndërtim auto mikser të betonit me peshë totale prej 16 T ashtu sic është kërkuar në dosjen e tenderit,

-Një kamion i prezantuar nga OE “4 AM” nuk ka dëshmi se ka konstruksion- ndërtim me auto pompë për betonim me peshë totale min. 16 T ashtu sikur që është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

8. Katalogu i prezantuar nga OE. “4 AM” e prodhuesit “V-TAC” nuk i plotëson specifikat minimale sa i përket efikasitetit të ndriçueshmërisë i cili duhet të jetë më i madh ose ekuivalent me 170 lm/ë.

9. Nuk ka dëshmi se prodhuesi **Schneider Electric Bulgaria** ka lëshuar AUTORIZIM për kompanin “A BI ESSE”, në ofertën e kompanisë “4 AM” është një dokumenti titulluar “DEKLARATË”, dhe nuk është askund AUTORIZIMI, dhe është në kundërshtim me kërkesën e AK të cekur në pozicionin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së ku kërkohet dokumenti autorizimi dhe jo deklaratë.

**PROVË:** Dokumenti i bashkangjitur

10. Mungojnë EN certifikatat e prodhuesit **Schneider Electric Bulgaria**, dhe nuk ka dëshmi të mjaftueshme për këto produkte, pasi që AK ka kërkuar që të gjitha produktet që janë pjesë e projektit të jenë me standarde EN, ku si dëshmi janë kërkuar Certifikatat EN.

11. Mungojnë poashtu EN certifikatat për prodhuesin **Tamburrini alessandro** dhe nuk ka dëshmi të mjaftueshme për keto produkte, pasi që AK ka kërkuar që të gjitha produktet që janë pjesë e projektit të jenë me standarde EN, ku si dëshmi janë kërkuar certifikatat EN.

12. Nuk ka dëshmi se prodhuesi **Tamburrini alessandro** ka lëshuar “AUTORIZIM” për kompanin “IDK Construction”, në ofertën e kompanisë “4 AM” është një dokument i titulluar “CERTIFICATO DI GARANZIA” dhe e perkthyer në gjuhën shqipe “CERTIFIKATE GARANCIE”, dhe nuk është askund autorizimi, dhe është në kundërshtim me kërkesën e AK të cekur në pozicionin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së ku kërkohet dokumenti AUTORIZIM dhe jo Certifikatë.

**PROVË:** Dokumenti i bashkangjitur.

13. Nuk ka dëshmi se prodhuesi **Vernisol** ka lëshuar “AUTORIZIM” për kompanin “IDK Construction”, në ofertën e kompanisë “4 AM” është një dokument i titulluar “CERTIFICATO DI GARANZIA” dhe e perkthyer në gjuhën shqipe “CERTIFIKATE GARANCIE”, dhe nuk është askund autorizimi, dhe është në kundërshtim me kërkesën e AK të cekur në pozicionin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së ku kërkohet dokumenti AUTORIZIM dhe jo Certifikatë.

**PROVË:** Dokumenti i bashkangjitur.

**Supozohet se AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RrUOPP-së sepse dokumentet e ofruara**

shtesë nga ana jonë në lidhje me sqarimin e DUD-ave Doganor në lidhje me pajisjet si eskavator, për shkak të disa lëshimeve teknike të agjencionit të shpeditonit, **sepse e ka shënuar Bager e jo eskavator** na refuzon ofertën tonë dhe na eliminon padrejtësisht, kur dihet se përmes e-mailit dhe provave që ia kemi bashkangjitur e kemi njoftuar AK që mund të verifikoj pajisjet të dal në vendngjarje për ti shiquar eskavatorët si dhe kemi kërkuar nga AK që mund të kërkoj sqarime në lidhje me termin “Bager” nga ana e Doganës së Kosovës, mirëpo edhe përkundër këtyre sqarimeve për shkak të një gabimi/termi gjuhësor AK rrezikon buxhetin dhe fondet publike duke e shpërblyer një ofertues i cili del të jetë i papërgjegjshëm administrativisht dhe teknikisht pas të gjeturave gjithmonë duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga ana e AK-së neve si OE pjesëmarrës gjatë qasjes në dokumentet publike.

AK në vend që ta cilësoj si devijim i vogël këtë përshkrim në DUD-at doganor e cila nuk e prek asnjë aspekt të tenderit dhe të e ruaj buxhetin/fondet publike, vendos në favor të OE tjetër.

Duke u mbështetur në paragrafin 39.3 i nenit 39 të RrUOPP-së thotë: Megjithatë lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marr informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë në mënyrë objektive duhet të prezantojnë se kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të aplikacionit apo dorëzimit të tenderit. Përveç kësaj kërkesa nuk do të duhej që të favorizoj apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.

39.4 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë mundësin e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë operatorët ekonomik dhe do të kërkoj informacion nga operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit përmbajtjes së deklaratave të paqarta certifikatavë të përfshira në tender apo kërkesave për pjesëmarrje.

**Supozohet se AK ka shkelur nenin 42 të LPP-së dhe nenin 43 të RrUOPP-së** sepse nuk e ka bërë publikimin e njoftimit për vendimin e Autoritetit kontraktues ashtu siç parashihet me rregullore të cekur të cekur në nenin 43.7, andaj me këtë rast kemi hasur në këto shkelje.

43.7 AK përpos letrave njoftuese standarde të shënuara më lartë, duhet që të përgatit njoftimin për “Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” dhe të ngrit në platformën e prokurimit elektronik si dokument shtesë nëpërmjet funksionit “shtoni dokument të ri”.

43.8 AK duhet që “Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” ta ngrit në platformë dhe të njëjtën ditë t’i lëshoj letrat njoftuese.

#### **VËMENDJE:**

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve të datës 23.05.2018 kemi vërejtur që anëtari i komisionit “Kryesuesi” i caktuar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës z.Hysen Merovci, nuk e kishte nënshkruar raportin e vlerësimit, në arsyetimin se ishte tërhequr dhe kishte dhënë mendimin e tij si Kryetar i Komisionit të Vlerësimit se në mesin e 23 operatorëve ekonomik janë vetëm dy (2) OE të përgjegjshëm, ku OE i rekomanduar për kontratë “4-AM” nuk ishte OE i përgjegjshëm, mirëpo zyrtari përgjegjës i prokurimit, duke u bazuar në dy mendimet e anëtarëve të komisionit të vlerësimit e bënë të përgjegjshëm OE tani të rekomanduar për kontratë dhe njërin prej OE që supozohej se ishte i përgjegjshëm e shpall të papërgjegjshëm, gjë që na bënë të mendojmë se mund të ketë pasur ndonjë manipulim, pasi që edhe ne si OE ankues gjatë analizimit të dokumenteve të këtij OE të rekomanduar për kontratë kemi konstatuar se nuk është i përgjegjshëm administrativisht.

Poashtu Autoriteti Kontraktues nuk iu është përgjigjur të gjitha pretendimet tona ankimore, në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk na është përgjigjur pretendimit tonë se AK ka shkelur nenin 42 të LPP-së dhe nenin 43 të RrUOPP-së sepse nuk e ka ngrit/publikuar Vendimin e AK-së e cila duhet të publikohet para njoftimit për dhënie të kontratës.

Andaj duke u bazuar në pretendimet e lartëcekura kërkojmë të anulohet Vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, propozojmë që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **RIVLERËSIM**.

**Procesi i prokurimit:**

Data e njoftimit për kontratë:	28.02.2018
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë Pune, Vlera e madhe – 24 muaj
Vlera e parashikuar e kontratës:	8,000,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52):	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:	10.04.2018 ora 12:00
Data e hapjes së ofertave:	10.04.2018 ora 12:00
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave:	29.05.2018
Data e njoftimit me letërën standarde për tenderues të eliminuar	29.05.2018
Data e njoftimit për dhënien e kontratës:	01.06.2018
Data e kërkesës për rishqyrtim:	06.06.2018
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:	12.06.2018

**ANKESA nr.279/18 – OE ankues “Mirusha Company” - Klinë**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Mirusha Company” shpk - Klinë, janë:

**Neni 7 – Barazia ne trajtim/Jo-diskriminimi (LPP), par.1,2,3,4,5,6**

**Neni 59 – Vleresimi, krahasimi dhe ekzhaminimi i tenderëve, paragrafi 1,2,3,4**

**Neni 60 – Kriteret e Dhënies së kontratës, paragrafi 1; 1.2**

**DEKLARATË MBI FAKTET DHE ARGUMENTET**

Letrën standarde për tenderues të eliminuar e kemi pranuar, por asnjë nga pretendimet e Autoritetit Kontraktues mbi eliminimin tonë fare nuk qëndrojnë nga ne që kemi ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në AK.

Sa i përket pretendimit të AK qe ne nuk kemi ofruar dëshmi për një finisher siq është kërkuar në dosjen e tenderit, ne kemi dorëzuar me datën 16.05.2018 dokumente/informata shtesë: Marrëveshjen për dhënie me qera ndërmjet “Granit Com” shpk dhe “Ispe Com” shpk, ku këto dy kompani me datën 03.01.2018 e kanë arritur marrëveshjen për dhënien me qera të mjeteve dhe stabilimenteve në afat të caktuar nga 03.01.2018 deri 31.12.2018, ky pretendim duhet te hudhet poshte nga që finisheri i prezantuar në dosjen e tenderit është në listën e pajisjeve të Ispe Group shpk me të cilin kemi marrëveshje për Furnizim me asfalt.

Tek qeshtja e autorizimeve ne kemi dorëzuar me daten 16.05.2018 Autorizim nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi per sinjalizim horizontal dhe vertikal me kompanin Malesia bashkangjitur eshte dorezuar katalogu edhe ne gjuhen shqipe bashke me foto percjellese edhe ky pretendim eshte i paqendrueshem.

Poashtu edhe ne dosjen e tenderit ne kemi dorezuar katalogun nga kompania Bau Produktet per prodhimet e pajisjeve elektrike dhe trupave ndriçues por per shkak te vellimit te madhe te dokumenteve te dorezuara me Dorezim te informacioneve shtese, katalogu nuk eshte dorezuar prap me informata shtese.

EN standarde e produkteve si per sinjalizim horizontal dhe vertikal si dhe për pajisjet elektrike dhe trupave ndriçues i kemi dorëzuar në dosjen e tenderit poashtu edhe EN standarde kompanisë sonë ne i kemi dorëzuar, pastaj më nuk na është kërkuar ti dorëzojmë prap me informata shtesë.

Në listën e pajisjeve të dorëzuar në dosjen e tenderit AK pretendon se mungojnë informata mbi peshën e pajisjeve të dorëzuara konkretisht për Eskavatori PC340 marka KOMATSU, Tipi: PC340NLC-6K vp 2000,

Eskavator PC 340- Marka: HYUNDAI, Modeli: R29LC me numër të shasisë: 7A-H-0377 dhe Cilindri: BOMAG, Tipi: BË 100AD3 me nr.shasis: 101150513439, por ne informata shtesë kemi ofruar dëshmi si DUD-at Doganor që përshkruhet saktë pesha dhe foto përcjellës për secilin mjet veç e veç.

Autoriteti Kontraktues – KK.Gjakove ka bërë shkeljen e nenit 7 – Barazia në trajtim/jo-diskriminimi të nenit 59 ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve –Ligji të Prokurimit Publik si dhe Nenit 60 – Kriteret për Dhenien e Kontrates, pretendimet e parapara dhe të shpalosura me lartë asnjë nuk qëndrojnë dhe duhet të hudhen poshtë se ne jemi kompani me çmimin ekonomikisht më të favorshëm dhe të përgjegjshëm.

Autoriteti Kontraktues KK Gjakove në momentin e shpalljes Fitues të kompanisë “4-AM” shpk ka bërë shkeljet shkelje të nenit 7 – Barazia në trajtim/jo-diskriminim ku ka shpallur fitues një kompani me çmim shumë të lartë dhe të papërgjegjshëm, duke na anashkaluar neve si kompani me çmim më të lirë të përgjegjshëm.

Operatori Ekonomik i perzgjedhur për të shpërblyer me kontratë kompania “4-AM” shpk në dosjen e tenderit ka ofruar dëshmi : marreveshje për furnizim me asfalt me kompaninë “BES Group” shpk, por kompania “BES Group” shpk, nuk posedon licencë për bazë asfalti, licenca e prezantuar është në emër të kompanisë “AHN Group” shpk me nr.te biznesit 70537362 nr.te licences 452/KPMM/2015, Baza e asfaltit e vendosur në Miradi të Ulet – Fushe Kosove me emër të pronarit Nuh Morina, por kjo licencë në asnjë formë nuk mund të shfrytëzohet nga kompania “BES Group” shpk edhe pse kompania në fjalë “BES Group” shpk ka blerë biznesin “AHN Group” shpk dhe ka ofruar një dëshmi nga ARBK-ja të ndryshimit të emërimit por ky dokument ka ndërlidhje me licencën për bazë asfalti.

Arsyeja se nuk mund të shfrytëzohet është se “BES Group” shpk ka qmontuar bazen për prodhim të asfaltit dhe e ka zhvendosur në lokacion tjetër..

Organi kompetent për monitorimin, licencën dhe mbikqyrjen e licencave/lejeve për baze asfalti është Komisioni për Miniera dhe Minerale i cili parasheh që në momentin e ndryshimit të lokacionit licenca/leja paraprake nuk vlen.

Në “Mirusha Company” shpk ju kemi drejtuar me një kërkesë komisionit për Miniera dhe Minerale për qeshtjen në fjalë muaj më parë. Përmes Arkivit KPMM-ja është përgjigjur për kërkesën tonë si më poshtë:

**Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e ka pranuar kërkesën tuaj lidhur me informata për ndërmarrjen “AHN Group” shpk me nr.biznesit 70537262, informatat janë kërkuar me qëllim të njohjes se a posedon kjo ndërmarrje Licencë/Leje në KPMM.**

KPMM me anë të inspektoratit kanë inspektuar terrenin, janë marrë koordinatat e vendit ku ka qenë e vendosur fabrika e prodhimit të asfaltit – Baza e asfaltit e Ndërmarrjes “AHN-Group” shpk si dhe janë bërë foto me qëllim që gjendja e krijuar në terren të paraqitet sa më reale.

Gjatë inspektimit në terren Inspektorët e KPMM-së kanë konstatuar se fabrika e prodhimit të asfaltit e ndërmarrjes “AHN Group” ishte çmontuar dhe zhvendosur nga lokacioni për të cilën ka poseduar leje për aktivitete të veçanta.

KPMM ju njofton se kjo ndërmarrje nuk posedon më Fabrikën për prodhimin e Asfaltit në vendin Miradi të Ulet , KK Fushë Kosovë dhe nuk ka leje për aktivitet të veçantë Bazë Asfalti dhe e njëjta nuk mund të shfrytëzojë Lejen për Aktivitet të Veçantë me nr.452/KPMM/2015.

Në mënyrë që të pajiset me leje kjo ndërmarrje duhet të aplikojë në KPMM në Pajtim me Ligjin për Minierat dhe Minerale.

Duke u bazuar në përgjigjen e organit kompetent KPMM-se lehtësisht vërtetohet se OE. “4-AM” shpk është plotësisht i papërgjegjshëm nga që nuk posedon marreveshje për furnizim me asfalt , marreveshja e prezantuar nga ana e kompanisë “4-AM” nuk është valide , kompania “BES Group” shpk nuk ka të drejtë ta

shfrytezoj licencën e prezantuar.

Shkelje tjeter ka qenë fakti se kur AK-KK.Gjakovë na ka kërkuar informata shtesë, ndërsa neve na ka caktuar afatin prej 3 ditësh për ti plotësuar kërkesat për informacione shtesë.

Me qenë se AK-KK Gjakovë në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim të datës 12.06.2018 është arsyetuar se nuk kemi ofruar argument, dëshmi për pretendimet tona ankimore, në këtë rast ne ja bashkangjesim dëshmit përgjigjet nga ana e Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Kërkojmë nga Organi shqyrtues i Prokurimit që ta kthej lëndën në Rivlerësim, AK KK Gjakovë ta bëjë një vlerësim të drejtë, duke u bazuar në faktet e ofruara të anuloj vendimin për shpallje fitues të kompanisë “4 AM” shpk si kompani e papërgjegjshme, dhe të na shpallë neve fitues si operator ekonomik të përgjegjshëm me çmim ekonomiksht të favorshëm.

#### **ANKESA nr.283/18 OE ankues “Drini Company” shpk – Prizren**

#### **DISPOZITAT E SHKELURA TË AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Neni 7 – Barazia në Trajtim/jo diskriminimi

Neni 27 – Dosja e Tenderit

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi

Neni 56 i LPP-së – Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratës

Neni 65 – Provat shkresore

Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë

Neni 39 i Rregullave dhe UOPP-se – Sqarimi i Tenderëve

Neni 41 i Rregullave dhe UOPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi

Neni 18 i Rregullave dhe UOPP-së – Dosja e Tenderit

Neni 45 i Rregullave dhe UOPP-së – Formularët Standard

#### **Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet**

Ne me datë 01.06.2018 kemi pranuar Letrën standarde për Tenderues të Pasuksesshëm për shkak të çmimit më të lartë. Po në këtë datë ne kemi kërkuar qasje në dokumentacionin Tenderik të OE së rekomanduar për shpërbllim me kontratë. Qajsa na është mundësuar me datë 04.06.2018 në ora 13:30. Në qasje ne kemi kërkuar që të na jepet një kopje e gjithë matërialit, raportin e komisionit të vlerësimit dhe korrespondencat me OE e rekomanduar për kontratë.

Ne me datë 05.06.2018 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-KK Gjakovë, ndërsa me datë 12.06.2018 është marr vendim nga ana e AK KK Gjakovë.

Gjatë analizës së dosjes së Tenderit ne kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit të AK KK Gjakovë ka bërë shkelje flagrante të dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të udhëzimit operativ për prokurimit publik.

Me rastin e parashtrimit të ankesës për rishqyrtim AK KK Gjakovë nuk i ka marr për bazë pretendimet tona, duke i klasifikuar si të pabazuara, edhe pse ekzistojnë fakte të pamohueshme të vërtetuara si për nga aspekti teknik ashtu edhe ai administrativ. Për te gjitha pretendimet tona ne kemi kërkuar interpretim ligjor edhe nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, të cilët e kanë vërtetuar se me rastin e vlerësimit të këtij tenderi AK KK Gjakovë nuk i ka respektuar dispozitat ligjore.

Në vijim po ju paraqesim në mënyrë të detajuar faktet dhe argumentet një nga një të shkelura nga komisioni i vlerësimit të AK-së.

**- Formulari për dorëzimin e tenderit – Pjesa C**

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë “4-AM”, ka bërë shkelje flagrante të nenit 27 të LPP-së DOSJA E TENDERIT dhe nenit 18,45 të Rregullave dhe UOPP-së pasi që OE nuk ka plotësuar formularin standard të dorëzuar nga AK mirëpo e ka krijuar një dokument sipas dëshirës së tij.

Dëshmia 1: Formulari i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë

Dëshmia 2: Formulari i kërkuar nga AK

Këtu shihet qartë se dokumenti i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë “4-AM”, nuk ka të bëjë fare me Pjesën C : Formularin e Tenderit ashtu siç ka kërkuar AK. Pra, në këtë dokument mungojnë:

- Headeri (Pjesa ku janë të shënuara të dhënat e aktivitetit të prokurimit, titulli dhe numri i prokurimit);
- Footeri (Pjesa ku është shënuar lloji i procedurës së prokurimit dhe numerizimi i faqeve)
- Shënimet shpjeguese për OE
- Të gjitha sqarimet tjera për OE.

Pra, mungojnë të dhënat vitale të cilat e identifikojnë dhe e lidhin këtë pjesë me këtë aktivitet të prokurimit, në faqen e dyte dhe te trete nuk ka asnjë shenim që këto dy faqe i përkasin këtij aktiviteti të prokurimit.

Edhe vet qëllimi i vendosjes se Headerit dhe Footerit në një dokument është që pjesë të caktuara të një dokumenti të identifikohen si një teresi dhe pjesë perberese të tij.

Perdorimi i formulareve standard është i rregulluar me ligj, si AK dhe OE duhet ti përdorin ato. Ne vijim në mënyrë të detajuar do ti elaborojmë NENET e LPP-se dhe RrUOPP-së.

Neni 18 i RrUOPP-së ...

Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare.

Ajo përbehet nga :

- Formulari i Tenderit
- Lista e cmimeve

OE duhet të plotësojë dhe të nënshtkruaj formularin dy pjesët, sepse neqoftese formulari nuk është plotësuar kjo do të thotë se nuk ka ofertë.

Dëshmia 3 – Neni 18 i RrUOPP-së

Neni 32.2 i RrUOPP-së:

...Formulari i tenderit së bashku me të gjitha dokumentet tjera që kerkohen, **te plotësuara mirë dhe te nënshtkruara përbejnë Tenderin**

Dëshmia 4: Neni 32.2 i RrUOPP-së

Neni 45 i RrUOPP-së

45.2 “Përdorimi i formularëve standard”, këtu do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përbejnë të pakten të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jete të qarta dhe të kuptueshme për OE të interesuar.

45.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përbejnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos Logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes “header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde.

Dëshmia 5: Neni 45.2 dhe 45.3 i RrUOPP-së

Nga të gjitha nenet e më sipërme shumë qartë obligohen si AK ashtu edhe OE për përdorimin dhe plotësimin e formularëve standard, në asnjë rast nuk lejohet me ligj që të ndërhyj në formularët përveç në rastin siç parashihet në nenin 45.3 të RrUOPP-së që kompania ka të drejtë të vendos logo, emrin e kompanisë apo grafike në krye të faqes Header, apo kudo tjetër në dokumente standarde.

Pra, ndërhyrja, fshirja e informacioneve kryesore në Pjesën C: Formularin e Tenderit përbën shkelje flagrante të dispozitave igjore të lartëshënuara.

Për ti vërtetuar pretendimet tona me datë: 20.06.2018 kemi kërkuar interpretim ligjor nga KRPP, pikërisht për këtë rast.

*Dëshmia 6: Kërkesat për interpretim ligjor*

Në të njëjtën ditë na është kthyer përgjigje në kërkesat tona pra me datë 20.06.2018

*Dëshmia 7: Interpretimi ligjor nga KRPP*

Interpretimi i KRPP-së:

Të nderuar,

Konform nenit 87 paragrafi 2, nënparagrafi 2.8 të ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligji nr.05/L-068, Ligji nr.05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP ju ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Sipas Rregullave dhe Udhezuesit Operativ për Prokurim Publik neni 45.2 dhe neni 45.3, përcakton si në vijim, citojme:

*Përdorimi i formularëve standard", këtu do të thote se dokumentet e prokurimit duhet të permbajne te pakten te gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e percaktuara ne formularet standard si informacion te detyrueshem, dhe ne pergjithesi te jete te qarte dhe te kuptueshme per OE te interesuar.*

*45.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të permbajne kërkesat minimale te percaktuara ne formularet standard pa ndryshime ne permbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë ose pa fshirjen e ndonje kushti të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos Logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes "header" apo kudo tjetër ne dokumentet standarde.*

*Që do të thotë se nga Tenderuesi kërkohet të plotësohet, si dhe nga tenderuesi kërkohet të nënshkruhet aty si kërkohet në kete formular.*

Për më tepër kjo nënkupton se tenderuesit dhe as AK nuk i lejohet ti beje asnje ndërhyrje tektualisht në permbajtjen e ketj formulari qe do te rezultonte me ndryshimin e permbajtjes se tij, ose duke mos i ofruar te gjitha informatat qe kerkohen ne kete formular.

Ne RrUOPP gjithashtu në faqen 82 thuhet se:

**Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ**

Pra, edhe interpretimi i KRPP-se verteton se as AK dhe as OE nuk guxojne ti ndryshojne apo ti fshijne informatat qe jane ne formular, pra vetem te plotesohen formularet.

Që në këtë rast nuk ka ndodhur nga ana e OE të rekomanduar për kontratë.

Duke i referuar edhe interpretimit të KRPP-së, ashtu siç parashihet edhe në nenin 39 të RrUOPP-së tek.

“Varesisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne perputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-së.

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ
--	--	---------------------

AK KK Gjakoves eshte dashur ta refuzoj tenderin dhe shpalle te papergjegjshem pa kerkuar informacione shtesë . e njejta parashihet edhe ne nenin 18 te RrUOPP-së ku thuhet “OE duhet të plotësoj dhe te nënshkruaj formularin (dy pjesët), sepse në qoftë se formulari nuk është plotësuar kjo do të thotë se nuk ka ofertë”.

Te dy edhe AK KK Gjakove edhe OE i rekomanduar per kontrate kane bere shkelje te neneve te lartepemendura, i pari sepse nuk e ka eliminuar si te papergjegjshem OE, kurse i dyti pasi qe nuk i ka perdorur formularet standard.

## 2. katalogu i trupave ndriques

1. Ne DT pika 9.1 dhe 9.2 . Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale

- OE duhet te dorezoj autorizimin origjinal te prodhuesit ose dilerit per pajisje elektrike ose trupat ndriques.  
-Deshmia e kerkuar dokumentare autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi per pajisje elektrike dhe trupa ndriques. (me te cilen prodhuesi-perfaqesuesi, e autorizon operatorin per furnizim me pajisje elektrike dhe trupa ndriques si dhe katalog te detajuar).

Deshmia e tete – Kerkesat ne FDT – pika 9.1 dhe 9.2

Gjithashtu ne Dosjen e Tenderit ne pershkrimin e produktit jane kerkuar edhe karakteristikat teknike te trupave ndriques pika 5.0.8, si me poshte

### Deshmia 9 – Karakteristikat teknike te trupave ndriques

5.0.8	Trupi ndriques - Llamba komplet kompakte e LED teknologjis Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë. Llamba nga aspekti i dizajnit dhe kualitetit duhet ti plotësoj standardet Evropiane, EN 60598-2-3, EN 55015, EN 1547:2009, EN 61000-6-2: 2005: EN 61000-6-3:2007 dhe të ketë: • Mbrojtje mekanike; IP65 (IP66) • Qëndrueshmëri pune: $\geq 100\,000$ (h/pune) • Efikasitet të ndriqeshmërisë: $\geq 170$ lm/Ë • Në 50 000 (h/punë) të LED-it : L85/B20 • Temperaturë të ngjyrës: $\leq 4000$ K • Tension pune: 90...205 V (50Hz) • Faktor të fuqisë: $\geq 0.97$ • Temperaturë pune: (-40 ... +60)°C • Mbrojtje në goditje: IK08 • Me xham të rrafshët të temperuar me trashësi 4 mm si dhe rrezistent në teperaturë (EN 12150 +12001) • Me kënd të rrotullimit +/- 15 ° • Garancioni: $\geq 10$ vite. Llamba komplet kompakte e LED teknologjis me fuqi 150 Ë	copë	110.00
5.0.9	Furnizimi transporti dhe montimi i ankerave per trupa ndriques me 4 bulona me dimensione te dhena ne pjesen grafike.	copë	59.00

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalog për produktet e ofruara të cilat nuk i plotësojnë specifikacionet teknike minimale.



*Dëshmia 10: Katalogu i dorëzuar nga OE për Trupat ndriçues dhe standardet EN*

Në katalog shihet qartë se efikasiteti i ndricueshmërisë është 12000 lm, ku i njëji nëse pjestohet me fuqi prej 150 ë, del të jetë 80 lm/W, kuse në dosje te tenderit është kërkuar të jetë me shume >170 lm/W. Ky është parametri kryesor tek trupat ndriçues pasi që ky e përcakton edhe efikasitetin e tij. Këtë mos plotësim e ka vërtetuar edhe vet komisioni i vlerësimit të AK, pasi që vet në kërkesën për sqarime shtesë thotë se:

***Katalogu i prezantuar nga ju për llambat e ndriçimit nga prohuesi V-TAC nuk i plotëson specifikat minimale sa i përket efikasitetit të ndriçueshmërisë i cili duhet të jetë më i madh ose i barabartë me 170 lm/W. Kërkojmë sqarime sipas nenit 72 të LPP-se.***

*Dëshmia 11: Letra për sqarime shtesë e dërguar tek OE i rekomanduar për kontratë dhe përgjigjet e OE*

*Të cili në vend se ta shpallë të papërgjegjshëm për mosplotësim të specifikacioneve teknike, ata kërkojnë sqarime shtesë kundërligjshëm. Kjo bie ndesh me nenin 39 të RrUOPP-se, ku thuhet:*

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Pra, komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kete nen.

Edhe për kete ceshtje kemi kërkuar interpretim ligjor nga KRPP, të cilët e kanë vërtetuar se AK Komuna e Gjakovës ka vepruar në kundërshtim me ligjin,

*Dëshmia 6: Interpretimi i KRPP-se*

*Interpretimi i KRPP-se*

Sa i përket pyetjes nr.2 lidhur me katalogun, Nese e kemi kuptuar drejt pyetjen si që ju na shkruani se “Nese katalogu i dorëzuar nuk plotëson specifikacionet e kërkuara nga AK” sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik neni 39 faqe 82 citon: Është dorëzuar specifikacioni teknik për mallrat e ofruara por mungon katalog, thuhet se :

Mund të kerkohen informata sqaruese, mirepo ***nese katalogu eshte dorëzuar, por nuk i plotëson specifikat e kërkuara nga AK, atehere në kete rast nuk mund të jete i pranueshem për AK.***

Komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje flagrante ligjore me rastin e kerkimit të sqarimeve shtesë pasi që pranimi i dokumenteve tjera që nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit përbejnë ndryshim material dhe janë në kundërshtim me nenin 59 pika 2 të LPP-se ku thuhet:

Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe ***asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.***

***Kjo vërtetohet edhe letra sqaruese e OE ku thhet se gjeni të bashkangjitur katalogun për llambat e ndriçimit të pridhuesit V – TAC sipas specifikacioneve të kërkuara për efikasitetin e ndriçueshmërisë. Me kete pohon edhe vet OE. 4-AM se në herën e parë nuk i ka plotësuar specifikacionet teknike e tani po, kjo është një ndryshim material pa që ka ndryshuar komplet produkti në ofertë”.***

*Dëshmia 11: Letra per sqarime shitese e derguar tek OE i rekomanduar per kontrate dhe pergjigjet e OE-ve*

OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem.

Për më tepër, trupi ndriques as në katalogun e dorëzuar me ofertë, as në katalogun e dorëzuar përmes sqarimeve shtesë nuk i plotëson të dhënat e temperaturës punuese. Ne dosjen e tenderit pika 5.0.8 është kërkuar qe temperatura punuese e trupit ndriques të jetë nga -40...+60 °C, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar trup ndriques me temperature punuese nga -40....+35 °C. Realisht një trup ndriques i tillë është pakuptimtë fillimisht të pranohet nga komisioni i vlerësimit e le me të instalohet.

Nuk e kemi të qartë se si AK KK Gjakovë e ka pranuar një trup ndriques me një temperaturë të tillë punuese, ku kërkesa e tyre eksplicite ka qenë -40....+60 °C

*Dëshmia 14: Katalogu i dorëzuar nga OE për trupat ndriques pas sqarimeve shitesë*

Gjithashtu në dosjen e tenderit trupi ndriques është kërkuar të jetë në harmoni me standardet europiane EN-60598-2-3, EN-55015, EN-1547:2009, EN 61000-6-2; 2005: EN 61000-6-3, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar as këtë kërkesë pasi që ka ofruar dëshmi se është konform standardeve: **EN-60598-1” 2008+A11:2009, EN 60598-2-2:1996+A1:1997, EN 62031:2008, EN 61347-1:2008+ A1:20011, EN 61347-2-13:2006, EN 62471:2008, EN 62493:20010.** Pra trupi ndriques nuk është në harmoni me standardet e kërkuara nga AK KK e Gjakovës.

*Dëshmia 10: Katalogu i dorëzuar nga OE për trupat ndriques dhe standardet EN*

Me këtë rast komisioni i vlerësimit të AK KK Gjakovë ka bërë shkeljen ligjore të nenit 59 i LPP-së, Vlerësimi, krahasimi dhe ekzaminimi, Neni 56 të LPP-së Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënia e Kontratave dhe Neni 41 i Rregullave dhe UOPP-se – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i plotëson kërkesat minimale të specifikimeve teknike të kërkuara ne dosjen e tenderit.

Për mosplotësimin e specifikacioneve teknike ekziston edhe vendimi i OSHP-së nr.81/17;86/17;91/17 i datës 02.05.2017 për çështjen e njëjtë për një aktivitet tjetër të prokurimit në mes të kompanisë tonë NNT. “Drini Company” shpk dhe AK Komuna e Gjakovës. Në këtë vendim qartë vërtetohen shkeljet dhe ankesa e jonë pikërisht për çështjen e njëjtë vërtetohet plotësisht e bazuar.

*Dëshmia 13:Vendimi i OSHP-së 81/17, 86/17,91/17 i datës 02.05.2017*

### **3. Katalloget per sinjalizim horizontal dhe vertikal**

OE i rekomanduar për shpërblim me kontratë ne dosjen e tenderit ka ofruar autorizim nga kompania IDK Konstruksion nga Shqipëria, kjo e fundit është autorizuar nga kompania VERNISOL s.p.a. ITALI per sinjalizim horizontal dhe TAMBURRINI ALESANDRO për sinjalizim vertikal. Të dy këto kompani prodhuese te produkteve përkatëse.

Ne pikën 9.1 & 9.2 te dosjes se tenderit janë kërkuar:

*“Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi për sinjalizim horizontal dhe vertikal”. (Me të cilën dëshmohet se prodhuesi përfaqësuesi autorizon operatorin për furnizim me komponentët e sinjalizimit horizontal dhe vertikal si dhe katalogë të detajuar)”.*

OE i rekomanduar për kontratë në dosjen e tij ka prezantuar katalog të kompanive italiane në gjuhën italiane, që nuk është gjuhë zyrtare, dhe kjo përbën shkelje ligjore të nenit 13 par.4 të LPP-së ku thuhet:

“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”.

#### *Dëshmia 12: Katalloget e dorëzuar nga OE*

Në pikën 6.1.1 të përshkrimi i çmimeve në dosjen e tenderit janë dhënë specifikat teknike për sinjalizim vertikal, ku kërkohen të jenë:

*Tipi i foljes: Diamond Grade, Ndritshmëria ditën: Min 27-luminance, Koeficienti i reflektueshmërisë 580-420-120 Cd/Luxm2, Jetëgjatësia e retroreflektimit të folies 1-7 vite 80% ulje reflektive, 8-11 vite 70% ulje reflektive*

Në kataloget e prezantuara nga OE prodhues TAMBURRINI ALESSANDRO, nuk ka të dhëna teknike për kërkesat e AK. Këta kanë prezantuar vetëm katalog të shenjave e jo të karakteristikave të qëndrueshmërisë sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Gjithashtu edhe në pikën 6.0.1 sinjalizimi horizontal janë kërkuar që produkti të ketë këto karakteristika: “trashësia 2-3 mm me masë dy komponente plastike e ftohtë, tipi i ngjyrës acryl, masa reflektuese sec 100-600 T14:0.25 Kg/m2”

As në katalogun e kompanisë VERNISOL S.p.a. nuk ka të dhëna teknike për tipin dhe materialin e sinjalizimit horizontal të kërkuar nga AK KK Gjakovë.

Edhe në këtë rast komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me ligjin përkatës nënin 59 të LPP-se dhe 41 të RrUOPP-se, pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ka dështuar të plotësojë kërkesat minimale të kërkuara në specifikacionet teknike të dosjes së tenderit.

Me katalogjet e ofruara OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të plotësojë as minimumin e kërkesave të specifikimit teknik të detyrueshëm që është në kundërshtim me nenin 59 par.4 i LPP-se dhe nenin 41 të Rregullave dhe UOPP-se.

Ku parimet kryesore sipas procedurës së vlerësimit të LPP-se janë:

1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.
2. Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).
3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.
4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.
5. Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.
6. Asnjë negociim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të LPP.
7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-se.
8. Dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura më lartë.

Pra, OE i rekomanduar për shpërbllim me kontratë ka dështuar t'i përmbush kërkesat administrative sipas pikës 9.1 & 9.2 të dosjes së tenderit. Ndërsa komisioni i vlerësimit ka bërë veprime të qëllimshme duke i shkelur të drejtat ligjore vetëm e vetem që me çdo kush të bëjë të përgjegjshëm këtë OE.

Pra, AK duhet ta s'kualifikoj OE e rekomanduar për kontratë, duke e zbatuar nenin 67 të LPP-së, pasi që sipas këtij neni OE nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme dhe nuk i ka plotësuar kërkesat minimale të dosjes së tenderit, ku shprehimisht në këtë nen thuhet:

*“Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet: (i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohet nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës”*

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat minimale administrative dhe teknike profesionale të dosjes së tenderit.

Pra:

**Ka shkelur nenin 72 të LPP-se DOSJA E TENDERIT – dhe nenit 18,45 të Rregullave dhe UOPP-së**, duke e shpallur të përgjegjshëm një OE i cili nuk e ka plotësuar kushtin themelor administrativ. Nuk e ka plotësuar në dosjen e tenderit, por e ka ndryshuar përmbajtjen e formularit, duke i fshirë elementet vitale të tij.

**Ka shkelur nenin 59,69 të LPP-së dhe 41 të RrUOPP-së**, duke shpallur të përgjegjshëm një OE i cili nuk i plotëson kërkesat minimale të specifikacioneve teknike.

**Ka shkelur nenin 56, par.1 dhe 1.1**, duke mos i respektuar kërkesat për specifikacione teknike të vendosura vetë në dosjen e tenderit.

**Ka shkelur nenin 59 par.2 te LPP-së**, duke pranuar ndryshimin material. AK ka pranuar ndryshim të produktit të ofruar, pasi që edhe vet e ka identifikuar se katalogu i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat minimale të specifikacioneve teknike.

**Ka shkelur nenin 72 te LPP-së**. Duke kërkuar sqarime shitesë nga një OE i papërgjegjshëm,

**Ka shkelur nenin 39 të RrUOPP-së faqe 82**, pasi që e kanë vertetuar se katalogu nuk i plotëson kërkesat minimale nuk e kanë refuzuar tenderin ashtu sic parashihet në kete nen: Eshte dorëzuar katalogu po mungon specifikacioni teknik – refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm.

**Ka shkelur nenin 7 te LPP-se, Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi** – duke mos na trajtuar barabarsisht pasi që ne jemi OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet prokurimi, kjo vërtetohet edhe me raportin e vlerësimit.

Nga të gjitha faktet e lartepërmendura kërkojmë nga OSHP që ankesën tonë ta aprovoj si të bazuar dhe lenda të kthehet në rivlerësim. Pasi që janë të evidentuara shkeljet flagrante të dispozitave ligjore të LPP-se, dhe i njëjti OE ka deshtuar që të plotësojë kërkesat minimale të dosjes së tenderit.

## **ANKESA nr.291/18 te OE “KAG-ASFALT” – Prizren**

### **DISPOZITAT E SHKELURA TË AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Neni 1 – Qellimi (LPP)

Neni 7 – Barazia në Trajtim/jo diskriminimi

Neni 27 – Dosja e Tenderit

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi

Neni 60 – Kriteret e dhenies së kontrates

Neni 68 – Gjendja ekonomike dhe/ose financiare

Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

### **DETAJET MBI FAKTET DHE ARGUMENTET**

Kompania KAG Asphalt është shpallur e papërgjegjshme sipas “Letrës standarde” të dërguar nga AK për arsye që sipas tyre nuk kemi prezantuar “Licencën për rrëdhë dhe zhavorë”, dhe nuk e kemi një katalog në gjuhën zyrtare të njërit nga prodhuesit.

Por kë këto sqarime ju kemi dërguar sipas kërkesës tuaj sipas nenit 72 të LPP-së për informacione shitesë dhe në përgjigjet tona të datës: 16.05.2018 i kemi cekur qartë përgjigjet tona, por po ju sqarojmë edhe një herë që: Kompania jonë në dosjen e tenderit ka paraqitur: “Leje për aktivitete të veçanta” 524/KPMM/2017, “Leje për sortues” e datës 06.04.2018, nr.protokolli: 1228 me kohëzgjatje deri me datë: 26.03.2022, e cila përmbush kërkesat e licencës për rrëdhë dhe zhavorë dhe këtë konfirmim e kemi marrë edhe nga zyrtarët e KPMM-së.

Ndërsa pikë e dytë e eliminimit sipas juve është që sa i përket katalogëve ne i kemi paraqitur në gjuhën që përdor edhe vet prodhuesi, dhe nuk është kërkuar që katalogu të jetë në shqip dhe në gjuhët e tjera. E

rendesishme eshte qe certifikatat dhe atestet e dorezuara janë në gjuhën angleze dhe të njohura ndërkombëtarisht për cilësinë dhe njëherit të bashkangjitur me kete katalog është edhe një katalog në gjuhën angleze.

Poashtu edhe ne kemi kerkuar edhe qasje ne dokumente zyrtare shpalljes se njoftimit per dhenie te kontrates dhe me date 05.06.2018 kemi pasur qasje ne dokumentet zyrtare

Ne qasje ne dokumentacion zyrtar ku zyrtarja e prokurimit na ka ofruar dokumentacionin e kompanise fituese ne kopje fizike dhe pas shikimit te dosjes se kompanise "4-AM" kemi verejtur qe kompania fituese nuk i plotëson kushtet e kerkuara sipas dosjes së tenderit.

Kompania fituese sipas dokumentacionit që na është ofruar ne kopje fizike nuk i ka përmbush këto kushte:

1) Formulari i dorëzimit të tenderit nuk është plotësuar si duhet, pasi që vlefshmëria e tenderit është kërkuar që të jetë 90 ditë, kurse Operatori ekonomik fitues e ka shenuar 120 dite, e cila sipas Rregullores dhe Udhezuesit Operativ te Prokurimit Publik, konkretisht paragrafi 39.8 i kesaj rregullore tregon qarte ne teble qe nese: "Formulari i Tenderit nuk eshte plotesuar si duhet apo mungon", eshte "kusht administrativ" dhe thote qe "Refuzo tenderin pa kerkuar informacione te metejme"; ndersa poashtu mungon edhe pjesa e dyte konkretisht identifikimi i operatorit ekonomik qe duhet nenshkruar dhe vulosur nga OE.

2) Nuk eshte paraqitur garancioni i nënshkruar dhe i vulosur (origjinali) nga OE sic eshte kerkuar nga AK – "Garancioni i shkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik se merr pergjegjesi per sanimin ose nderrimin per te gjitha sherbimet, furnizmet dhe punet per projektin ne fjale minimum në afat prej 12 muaj pas pranimit teknik".

Poashtu ne kemi pasur qasje konkretisht na jane dorezuar në mënyrë elektronike dhe kopjet e eliminimit të operatorëve tjerë ekonomik të cilët po i cekim në pika të shkurtëra dhe me këtë vërtetohet se të gjithë operatorët tjerë ekonomik para kompanisë sonë janë të papërgjegjshëm duke përfshirë edhe kompanin fituese.

Kompania "EuroAsphalt" ka mungesë dokumentacioni për plotësimin e makinerisë të kërkuar;

Kompania "Mirusha" ka mungesë të makinerisë , mungojnë autorizimet, EN standardet e prodhuesit mungojne etj.

Kompania "Lirigzoni" ka mungesë të makinerise dhe nuk i ka plotësuar kriteret e kerkuara për autorizimet e përfaqësuesit ashtu sic është kërkuar në dosjen e tenderit nga AK.

Kompania "Bejta" ka gabime aritmetikore në plotësimin e paramasës.

Kompania "RSM" ne listën e çmimeve tek Ndërtimi i kanalizimit fekal – Punët tokësore saktësishtë në pozicionin 4.1.1 "Pastrimi i terrenit" nuk kane ofertuar me cmim per njesi.

Kompania "Arfa" e cila ka qene ne konzorcium me kompanin "Fat Group" dhe kjo kompani nuk eshte e regjistruar ne Platformen e E-prokurimit dhe e ben te papërgjegjshme.

Ndërsa në raportin e vlerësimit të tenderëve shihet qartë që ka kundërthënie në mes të kryetarit të komisionit të vlerësimit dhe dy anëtarëve tjerë, konkretisht kryetari ka propozu për dhënie të kontratës kompanin "KAG Asfalt" shpk dhe i njëjti ju ka dorëzu këtë rekomandim citoj nga raporti i vlerësimit:

"rekomandimi i kryetarit të komisionit të vlerësimit nga 23 OE që kishin ofertu në këtë aktivitet, vetëm 2 janë të përgjegjshëm:

1- Kag Asfalt shpk ne vlerë prej 2,649.075.00 €

2- NNTSH. "Drini Company" shpk me vlerë 2,995,589.38 €

Ndërsa rekomandimi i anëtarëve të komisionit është citoj:

"Me datë 25.05.2018 dy anëtarët e tjerë të komisionit kanë dorëzuar edhe në mënyrë elektronike dhe në mënyre fizike të nënshkruar rekomandimin e këtij aktiviteti, dhe rekoamdnimi i tyre ka qene se nga 23 OE qe kishin ofertuar ne kete aktivitet, vetem dy jane te pergjegjshem:

1-"4 AM" shpk me vlerë 2,618,594.85 euro

2-NNTSH. Drini Company me vlere 2,995,589.38 euro

Andaj duke pasur parasysh që janë dy raporte kundërthënëse në mes tyre menaxherja e prokurimit e merr si të bazuar vetëm raportin e dy anëtarëve të komisionit pa nënshkruar pa nënshkruar kryetari i komisionit i caktuar nga MI dhe e shpallë fitues kompanin “4-AM”.

Andaj duke u bazuar në faktet e paraqitura më lartë konsiderojmë se jemi kompania më e lirë e përgjegjshme në mesin e kompanive të cilat kanë ofertuar me cmim më të lirë dhe kërkojmë që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

### Kriteret për vlerësim:

#### **Kërkesat e përshtatshmërisë:**

Operatori Ekonomik duhet ti përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Vërtetim nga Gjykata kompetente.

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.

Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues). Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).

#### **Përshtatshmëria profesionale:**

1/Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;

2/Certifikata e Numrit Fiskal;

3/Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK

4/Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Kualitetit ISO 9001:2015 ose ISO 9001:2008

5/Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të sigurisë në trafik rrugor ISO 39001:2012

6/Licence-leje të lëshuar nga KPMM-ja ose kontratë nga një ndërmarrje e licensuar nga KPMM-ja (për rrëzë dhe zhavorre, material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë e asfaltit)

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

1/ Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje);

2/ Certifikata e numrit fiskal (kopje).

3/Certifikata e TVSH-se (kopje)

4/ Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Kualitetit ISO 9001:2015 ose ISO 9001:2008 (kopje)

5/ Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të sigurisë në trafik rrugor ISO 39001:2012 (kopje)

6/ Licence-leje të lëshuar nga KPMM-ja ose kontratë nga një ndërmarrje e licensuar nga KPMM-ja (për rrëzë dhe zhavorre, material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë e asfaltit) (kopje)

#### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1/Pasqyrat financiare të audituara për 3 (tri) vitet e shkuara.

2/Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme prej së paku

7.000,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

1/Kopja e pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e shkuara dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licensuar ose ndonjë Kompani e Auditimit – (Të bashkangjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit)

2/ Vërtetimi nga banka ose raport bankar i nënshkruar dhe vulosur i cili dëshmon se qarkullimi bankar i kërkuar në periudhën e tri

	viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë është i plotësuar sipas kërkesës.
<p><b>Kapaciteti teknik dhe professional:</b></p> <p>1/Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses referenca të cilat dëshmojnë se ka kryer punë të natyrës së ngjajshme në ndërtim dhe renovimin e rrugëve për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë;</p> <p>2/ Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (tridhjetë) punëtorë në listën e stafit të paraqitur në ATK (minimum viti 2017) si dhe duhet të ketë staf professional në minimum për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i Inxhinierisë së ndërtimit (drejtimi Konstruktiv apo Infrastrukturë Rrugore)</li> <li>- Një inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes ose Master i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike</li> <li>- Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë (drejtimi Hidroteknikë) ose Master i Inxhinierisë së Ndërtimit drejtimi Hidroteknikë</li> <li>- Një inxhinier i diplomuar i Komunikacionit ose Master i Inxhinierisë Mekanike drejtimi komunikacion (Transport)</li> </ul> <p>- Një Gjeodet ose teknik i Gjeodezisë (Gjeometër);</p> <p>3/Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a.) 4 ekskavator me peshë totale minimumi 13 t</li> <li>b.) 6 kamiona me konstruksion-ndërtim kiper - (të paktën 4 nga këta të jenë me peshë totale mbi 12 t)</li> <li>c.) 2 kamiona me konstruksion-ndërtim auto-mikser për transport të betonit me peshë totale minimum 16 t</li> <li>d.) 1 kamion me konstruksion-ndërtim me auto pompë për betonim me peshë totale minimum 16 t</li> <li>e.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale minimum 12 t</li> <li>f.) cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale minimum 4 t deri në 12 t</li> <li>g.) 1 grejder</li> <li>h.) 1 finisher.</li> </ul> <p>4/ Autorizimin origjinal i prodhuesit ose nga përfaqësuesi për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues;</p> <p>5/ Autorizimi e prodhuesit ose nga përfaqësuesi për sinjalizim horizontal dhe vertikal.</p> <p>6/ Të gjitha produktet që janë pjesë e projektit duhet te jene me standarde EN - të ofrohen certifikata për për standardet</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1/ Listën e punëve të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, për punë në ndërtim dhe renovimin e rrugëve. Duke saktësuar punimet e kryera, shumën e kontratës dhe datën.</p> <p>2/ Listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtoare.</p> <p>3/ Listën e mjetet-paisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD – i doganor, ose kontrata mbi qiramarrjen, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturë. (Lista duhet vërtetuar nga Operatori Ekonomik).</p> <p>4/ Autorizimin nga prodhuesit ose nga përfaqësuesi për pajisjet elektrike dhe trupa ndriçues. (Me të cilën dëshmohet se prodhuesi-përfaqësuesi autorizon operatorin për furnizim me pajisje elektrike dhe trupa ndriçues, si dhe katalogë te detajuar).</p> <p>5/ Autorizimin nga prodhuesit ose nga përfaqësuesi për sinjalizim horizontal dhe vertikal. (Me të cilën dëshmohet se prodhuesi-përfaqësuesi autorizon operatorin për furnizim me komponentët e sinjalizimit horizontal dhe vertikal si dhe katalogë te detajuar).</p> <p>6/ Produktet që janë pjesë e projektit duhet te jene me me standarde EN (Produktet e ndriçimit publik dhe sinjalizimit janë të specifikuara në pozicionet e paramasës së projektit), - te ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara.</p> <p>7/ Garancioni i shkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik se merr përgjegjësi për sanimin ose ndërrimin për të gjitha shërbimet, furnizimet dhe punët për projektin në fjalë minimum në afat prej 12 muaj pas pranimit teknik.</p>



EN të produkteve të ofruara.

7/ Operatorët Ekonomik duhet të ofrojë garancion për të gjitha shërbimet, furnizimet dhe punët së paku 12 muaj për projektin në fjalë pas pranimit teknik.

Sigurimi i tenderit 100,000 euro me afat 120 dite

Sigurimi i ekzekutimit 10% e vleres per 25 muaj

### Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	SHPK.“ALBA Construction” Dega-Kosovë	Prizren	3,369,976.70	JO
2.	SHPK. “4-AM”	Tiranë	2,618,594.85	JO
3.	Grup i operatoreve “Asfalti” & “Ilea-Gr”	Bellopoje	2,698,879.87	JO
4.	Grup i operatoreve “Hidroterm” & “Gashi-ing”	Suhareke	3,498,054.79	JO
5.	NPT.“Berisha Com”	Gjakovë	3,550,276.33	JO
6.	Grup i operatoreve “Toifor” & “Papenburg&Adriani”	Prishtine	2,989,212.36	JO
7.	Shpk. “Kag Asfalt”	Prizren	2,649,075.05	JO
8.	“FAMIS CO-HC” SH.A.	Prizren	2,987,707.81	JO
9.	Grup i operatoreve “Pe-vla-ku” & “Joss & Krasniqi Baze” shpk	Prishtine	2,945,831.36	JO
10.	NTSH. “Drini Company”	Prizren	2,995,589.38	JO
11.	NP. “Victoria Invest Internacional” shpk	Prishtine	2,984,116.19	JO
12.	“Armendi-Fa” SHPK	Istog	3,655,554.83	JO
13.	Grup i operatoreve “Burimi” & “Tam Metal” shpk	Malisheve	2,656,197.38	JO
14.	“Euroasphalt” shpk	Gjakove	2,167,951.71	JO
15.	“Renelual Tahiri” shpk	Prizren	2,876,446.00	JO
16.	“Mirusha Company” shpk	Kline	2,295,931.34	JO
17.	Grup i operatoreve “Bejta Commerce” & “Eurocom”& “Bass Com”& “Erniku”-perfaqesia Kosovë & “Gllame” shpk	Gjilan	2,580,943.28	JO
18.	“RSM Company”	Prishtine	2,598,193.70	JO

19.	NTSH. "ARFA"	Deqan	2,605,924.59	JO
20.	Grup i operatoreve "LIRIGZONI" & "King Holding" & "Marash shped" shpk	Skenderaj	2,480,937.05	JO
21.	"JEHONA" SHPK	Malisheve	2,727,420.89	JO
22.	"Lika Trade"	Decan	3,555,632.07	JO
23.	Grup i operatoreve "Victory Com" & "Gerlica Company" shpk	Gjakove	2,910,051.20	JO

**Komente nga Hapja: ARFA & FAT Group – Nuk ishin te regjistruar ne sistemin e e-prokurimit**

#### **Komisioni vlerësues pranë AK:**

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Hysen Merovci – Kryetar i komisionit (perfaqesues i MI-së)
- Lekë Sina – Anëtar i komisionit (Udheheqes i sektorit per komunikacion DSHP-Gjakovë)
- Elhamije Kumnova – Anëtar i komisionit (Bashkepunetore profesionale per energjii DSHP - KK.Gjakovë)

#### **Raporti i komisionit vlerësues:**

##### **Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:**

Përfaqësuesi i MI caktohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet MI dhe Komunës së Gjakovës. Komisioni i vlerësimit ka konstatuar që në këtë aktivitet kanë ofertuar 23 OE (1 OE ka ofertuar në mënyrë elektronike dhe 22 në mënyrë fizike).

Pas vlerësimit të pjesës së parë me datë 11.05.2018 (e premte) përmes e-mailit kryetari i komisionit ka dorëzuar të dy anëtarët e komisionit raportin preliminar për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i qarkores së Gjakovës - LOT 1" (bashkangjitur mund të gjeni komunikimin zyrtar në dosjen e tenderit). Dhe ka kërkuar që anëtarët e komisioni ta analizojnë këtë raport dhe të japin sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Me datë 14.05.2018 (e hënë), pas shqyrtimit të draft-raportit dy anëtarët e komisionit nuk janë pajtuar me raportin preliminar për këtë aktivitet dhe përmes e-mailave zyrtar kanë sqaruar dhe kanë rekomandu:

1. Asnjë nga Operatorët nuk është i përgjegjshëm, apo i plotë me dokumente ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit;
  2. Tetë(8) OE nuk janë të përgjegjshëm administrativisht, që do të thotë se eliminohen direkt. OE të eliminuar janë: Bejta, RSM, ARFA, Victory Com, Pevlaku, ALBA Construction, Berisha Com dhe Armendi.
  3. Rekomandimi i dy anëtarëve të komisionit ka qenë, që të gjithë OE tjerë duhet kërkuar dokumentacion dhe sqarime shtesë, duke u bazuar në ligjin për prokurim publik neni 72;
  4. Katër (4) OE që kryetari i komisionit që në raport i ka shpallur të përgjegjshëm, për mendimin e dy anëtarëve të komisionit kanë qenë të papranueshëm pasi që asnjëri nga ta nuk është i përgjegjshëm (sepse secilit i mungojnë dokumente të caktuara të cilët mund të ju kerkohen);
  5. Rekomandimi i dy anëtarëve të komisionit ka qenë që raporti që ka dërguar kryetari i komisionit nuk mund të jetë raport final sepse si i tillë është në kundërshtim në mes të operatorëve të përgjegjshëm dhe operatorëve të papërgjegjshëm (bashkangjitur në dosjen e tenderit komunikimet zyrtare).
- Pas analizimit të rekomandimeve nga anëtarët e komisionit menaxherja e prokurimit ka kërkuar që të respektohet neni 72 i LPP-së dhe të përgatiten të gjitha letrat standarde për OE të përgjegjshëm

administrativisht, duke mos përjashtuar respektimin e RrUOPP-së pika 39.1,39.2,39.4, 39.5,39.6,39.7,39.8 me datë 14.05.2018 të gjitha kërkesat për sqarime shtesë kanë qenë të përgatitura nga anëtarët e komisionit dhe po me atë datë janë dërguar 15 kërkesa për sqarime shtesë.

Me datë 17.05.2018 komisioni i vlerësimit ka filluar ekzaminimin e sqarimeve shtesë dhe ka përfunduar rekomandimet e tyre për këtë aktivitet me dt.25.05.2018.

Me datë 25.05.2018 kryetari i komisionit ka dorëzuar rekomandimin e tij të nënshkruar në zarfë përmes zyrës së arkivës së MI me shkresë zyrtare të protokolluar.

Rekomandimi përfundimtar i Kryetarit të komisionit ka qenë se nga 23 OE që kishin ofertuar në këtë aktivitet, vetëm 2 janë të përgjegjshëm:

- 1- Kag Asfalt shpk ne vlerë prej 2,649.075.00 €
- 2- NNTSH. "Drini Company" shpk me vlerë 2,995,589.38 €

Me datë 25.05.2018 dy anëtarët e tjerë të komisionit kanë dorëzuar edhe në mënyrë elektronike dhe në mënyrë fizike të nënshkruar rekomandimin e këtij aktiviteti, dhe rekoamdnimi i tyre ka qene se nga 23 OE qe kishin ofertuar ne kete aktivitet, vetem dy jane te pergjegjshem:

- 1-"4 AM" shpk me vlerë 2,618,594.85 euro
- 2-NNTSH. Drini Company me vlere 2,995,589.38 euro

Menaxherja e prokurimit pas shqyrtimit të rekomandimeve (njëri raport nga kryetari i komisionit – i nënshkruar vetëm nga kryesuesi, dhe raporti tjetër nga dy anëtarët, pasi që komisioni nuk është mbledh në mungesë të kryesuesit), shkresave të lëndës, shqyrtimit të ofertave dhe rekomandimet nga dy anëtarët e komisionit në bazë të nenit 40.13 të RrUOPP-së dhe neni 1 paragrafi 1 të LPP-së, duke e respektuar gjithë legjislacionin për prokurim publik në fuqi vendos që oferta e OE. "4-AM" shpk me vlerë 2,618,594.85 € ashtu sic është rekomanduar nga dy anëtarët e komisionit vlerësues, të shpërblehet me kontratë pasi që është oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët.

Të gjitha komunikimet zyrtare me anëtarët e komisionit gjenden në dosjen e tenderit.

Të gjitha letrat standarde për secilin OE veç e veç, dhe të gjitha rekomandimet e komisionit gjenden në dosjen e tenderit..

**Ankesa nr.264/18 OE ankues konz. "Pevlaku" & "Joos & Krasniqi Bazë"**

**Sqarimi:**

AK-Komuna e Gjakovës ka zhvilluar procedurën për punë "Ndërtimi i qarkores së Gjakovës" llot I". Procedura e Hapur, Punë, Vlerë e Madhe.

AK i ka vlerësuar të gjitha ofertat dhe bazuar në pretendimet ankimore që ka patur OE ankues në ju kemi përgjigjur si në përgjigjet në vijim:

**Pretendimi i parë ankimor**

Eksperti shqyrtues i OSHP-së – sqaron se bazuar në pretendimin ankimor të konzorciumit OE. "Pe-Vla-Ku" & "Joos& Krasniqi – Bazë".

OE ankues pretendon se AK-Komuna e Gjakovës ka propozuar për kontratë OE. "4 A-M", ku OE i propozuar ka çmimin **2,618,594.85 €**

ku sipas pretendimeve ankimore të OE ankues (Konz.Pevlaku& Joos & Krasniqi-Bazë)

sipas pretendimeve ankimore të OE ankues se të hapet dosja për **Koncerziumin "PE-VLA-KU" shpk & "JOOS&Krasniqi-Bazë" shpk.**

**Eksperti i OSHP-së, sqaron se bazuar në këtë pretendim OSHP konsideron se Lënda kthehet në Rivlerësim dhe OE ankues në dosjen e tenderit ka dy kopje në dosjen e tij, dhe sipas Legjislacionit OE në rast se dyshon në lenden e tij mund të kërkojë hapjen e kopjes në AK, dhe nëse OE vëren parregullësi në kopjen e tij, atëherë kopjen e dytë do ta hap OSHP-ja. Kete e definon Pika (neni) 32.. i RrUOPP-së.**

32.3 Tenderi do të dorëzohet të AK në një formë të origjinalit dhe një numër të kopjeve të cilat AK i ka trajtuar në mënyrë të qartë në dosjen e tenderit.

**Kopjet Hapet në shërbim të komisionit vlerësues.**

Pretendimi i OE ankues është se OE i propozuar për kontratë (citim): **Me qasjen tonë kemi vërejtur se:**

**1. "4 AM" shpk** ka bërë marrëveshje për furnizim me rërë dhe zhavorr me kompanin "DREONI" shpk, kompani të cilës i ka skaduar afati i licencës.

**2. "4 AM" shpk** ka bërë marrëveshje për furnizim me beton me kompanin "BENITA COMPANY" shpk, kompani poashtu të cilës i ka skaduar afati i licencës.

**Përgjigje në pretendimin ankimor** në lidhje me marrëveshjet për furnizim me rërë dhe zhavorr në dosjen e tenderit të OE së propozuar për kontratë ("4 A-M") ka marrëveshje me "DREONI" shpk ku marrëveshja është nënshkruar me datë 07.03.2018, ka të bashkangjitur LICENCËN E SHFRYTËZIMIT me nr.1679/KPMM/2017 me afat të skadencës 05.06.2018

OE i propozuar ka marrëveshje për Furnizim me material nga gurorja (Gurë), marrëveshja e nënshkruar më datë 07.03.2018 në mes të "BENITA COMPANY" shpk dhe "4 A-M" shpk, ka të bashkangjitur LICENCË PËR SHFRYTËZIM me nr.738/KPMM/2008 ku afati i skadimit të licencës është 14.09.2020

OE i propozuar ka marrëveshje për Furnizim me Beton, marrëveshja e nënshkruar më datë 07.03.2018 në mes të "BENITA COMPANY" shpk dhe "4 A-M" shpk, ka të bashkangjitur LEJËN PËR AKTIVITETE TË VECANTA me nr. 432/KPMM/2015, ku afati i skadimit të licencës është 08.06.2018.

Në dosjen e OE së propozuar ka edhe një marrëveshje për furnizim me të gjitha llojet e asfaltit e nënshkruar me dt.07.03.2018 në mes të OE."4 A-M" shpk dhe "BES GROUP" shpk, marrëveshja e ka të bashkangjitur LEJEN PËR AKTIVITETE TË VECANTA me nr.452/KPMM/2015, por bartës i lejes në fjalë nuk është "BES GROUP" shpk, por "AHN Group" shpk nga Fushë Kosova, dhe afati i skadencës së kësaj leje është 21.10.2018, ku e ka të bashkangjitur një vërtetim nga ARBK që thotë se: "Vërtetojmë se biznesi i regjistruar me dt.29.10.2008 me nr.biznesit 70537362 "AHN GROUP" shpk ka ndryshuar emërtimin si "BES Group" dhe

pronar është Besim Bujupi me nr.personal 1010827619.

**Eksperti shqyrtues i OSHP-së sqaron :**

Licenca e shfrytëzimit për "BENITA COMPANY" shpk "Furnizim me gurë" (shkëmb të fortë) ka validitet deri 14.09.2020, Licenca për Furnizim "BENITA COMPANY" shpk për Furnizim me beton ka pasur afat në ditën e hapjes, por i ka skaduar afati me dt.08.06.2018

Licenca për Rërë dhe Zhavorr me "DREONI" shpk ka pasur afat në ditën e hapjes por i ka skaduar me dt.05.06.2018.

Licenca për Furnizim me asfalt e bartësit "AHN GROUP" shpk, por marrëveshja është bërë me "BES GROUP", pasi që sipas vërtetimit të ARBK-së të dt.07.07.2017 vërtetohet se është ndërruar pronari nga "AHN Group" në "BES Group", ka qene dashte të bëhet bartja me dokumente dhe licenca të merret si "BES Group" shpk. **Ne lidhje me licencën e asfaltit të AHN Group, ka qene dasht që edhe licenca të jete BES Group dhe jo AHN Group.**

Pretendimi ankimor i bazuar.

Pretendimi i OE ankues se OE i propozuar, ka dy raporte të pasqyrave financiare,

**Eksperti i OSHP-së** sqaron se janë dy raporte me vlera të njëjta, por njëra është AKTIVI dhe tjetra PASIVI sipas termit të Kontabilitetit që të dy raportet përputhen me vlerën AKTIVET= 2,037,750.839 , kurse PASIVET = 2,037,750.839 . Vlera monetare nuk dihet s a është llogaritur Euro apo Lekë, pasi që në Republikën e Shqipërisë paraja zyrtare është LEKU.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

**ANKESA 268/18 OE ankues "Euroasphalt"**

**Pretendimi i OE ankues:**

**Përgjigje në Pretendimin e parë ankimor**

Pretendimi i OE ankues "Euroasphalt" është se AK ka bërë shkeljen e nenit 1 dhe nenit 6 pasi që nuk i ka përdorë fondet publike pasi që oferta e OE ankues "Euroasphalt" është më e lirë se OE i propozuar ("4 A-M") me vlerë prej 450,643.13 €, me çrast AK ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paragrafi 1 i Neni 1 (Qëllimi) i LPP-së thotë: *"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla"*

Paragrafi 1 i Neni 6 (Ekonomiciteti dhe efikasiteti) i LPP-së thotë: *"Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit"*.

**AK-KK Gjakovë bazuar në nenin 1 dhe 6 sic i cekëm më lartë ka qenë dashtë të bëjë vlerësimin e ofertës dhe pasi që dallimi në çmim është 450,643.13 € me operatorin e propozuar për kontratë OE. "4 A-M", pasi që shfrytëzimi i fondeve publik është edhe qëllimi i ligjit...**

**Pretendimi ankimor i OE ankues i bazuar.**

**Pretendimi i dytë ankimor i OE ankues**

OE "Euroasphalt" Gjakovë në pretendimin e dytë thotë se: oferta e tij refuzohet për një gabim gjuhësor nga ana e shpeditarit gjatë përgatitjes së DUD-it doganor me rastin e importit të makinerisë përkatëse (Eskavatorëve përkatësisht bagerave, siç i ka emëruar shpeditari ynë).

Kurse si provë OE ankues i paraqet DUD-at që i disponon këto dokumente, në pikën 9.1 & 9.2 të FDT-së thotë:

Te kërkesat; Pika a) 4 ekskavator me peshë totale minimumi 13 t,

kurse te dëshmia : "Listën e mjetet-paisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD – i doganor, ose kontrata mbi qiramarrjen, ose kontratë mbi shit-blerje ose faturë. (Lista duhet vërtetuar nga Operatori Ekonomik)."

**OE ankues në dosjen e tenderit ka të bashkangjitur DUD-a dhe fatura..**

OE ankues në listën e mjeteve i ka të paraqitur 6 Eskavator, dhe se OE ankues i ploteson kriteret sipas listes.

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE ankues në lidhje me listen e makinerisë (pajisjeve) në dosje i ka të bashkangjitura dy fatura për dy eskavator :

1. Fatura nr.99 e datës 19.08.2010 ku përshkrimi i mallit është: Eskavator – Marka: ATLAS 1400, vlera e faturës 20,000 €, ku blerës figuron që është "Euroasphalt", ndërsa shitës NPT. "NOLI", kjo korrespondon me të dhënat e eskavatorit në listën e pajisjeve; dhe
2. Fatura tjetër me nr.02/13 e datës 01.03.2013 ku përshkrimi i mallit është Eskavator (Bager) i përdorur, Marka: CTAT, tyr-M318, ku blerës figuron që është "Euroasphalt" shpk, kurse shitës NPT. "Fetoshi" shpk, ku edhe kjo korrespondon me të dhënat e eskavatorit në listën e pajisjeve.

OE ankues poashtu me dosjen e tenderit ka të bashkangjitura edhe 3 DUD-a Doganor si në vijim:

1. Bager i përdorur Marka: LIEBHERR, Tipi L541, viti 1995 me peshe 17 000 kg, e që të dhënat përputhen me listën e mjeteve por që dallon vetëm emërtimi, ku në listë figuron Eskavator, ndërsa në DUD Bager i përdorur;

2. Bager i përdorur Marka: Furakawa, Tipi 365, viti 1998 me peshë 23000 kg, ku të dhënat përputhen në lidhje me listën e mjeteve por që dallon vetëm emërtimi.

3. Bager i përdorur Marka: Caterpillar, Tipi: 318 BL, viti 2001, me peshe 22 000 kg, ku të dhënat përputhen në lidhje me listën e mjeteve por që dallon vetëm emërtimi.

Pra, te 3 DUD-at Doganor dallon vetëm emërtimi i eskavator-Bager, ndërsa të dhënat e tjera përputhen me të dhënat e shënuara në listë.

Eksperti i OSHP-së sqaron se gjatë rivlerësimit të ofertave duhet të kërkoj informata shtesë në lidhje me emërtimin për 3 DUD-at Doganor. Bazuar në nenin 1 dhe 6 të LPP-së, eksperti i OSHP-së duke pasur parasysh faktet e shënuara më lartë si dhe faktin se OE ankues ka ofertuar me çmimin më të lirë në krahasim me të gjithë ofertuesit tjerë, si dhe faktin se ka ofertuar me çmim prej **450,643.13 € më lirë se OE i rekomanduar për kontratë rekomandon që të kërkojen informata shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe Pikën 39 të RrUOPP-së.**

**Pretendimi ankimor i OE ankues i bazuar.**

**Pretendimi ankimor në lidhje me nenin 7 të LPP-së (Trajtimi i barabartë/jo-diskriminimi)**

**OE ankues pretendon se AK nuk i ka trajtuar të gjithë OE-të në mënyrë të barabartë sepse në disa raste tek disa**

OE ka pranuar dhe lejuar devijime tjera tek operatori i rekomanduar për kontratë, kurse tek kompania jonë në disa gabime tekstuale të shpeditërëve e që nuk e prekin fare asnjë aspekt të tenderit nuk i cilëson si gabime tekstuale, me crast na eliminon, dhe përdor “Standarde të dyfishta”.

### **Përgjigje në pretendimin e dytë ankimor**

AK-KK.Gjakovë duhet ti trajtoj të gjithë OE sipas nenit 7 të LPP-së (Trajtimi i barabartë/jo-diskriminimi).

Pasi që pretendimi i OE ankues ishte se OE i propozuar nuk e ka vendosur çmimin në ofertën e tij.

Eksperti i OSHP-së, sqaron se gjatë shiqimit të dosjes së tenderit të OE-së së rekomanduar kemi vërtetuar se OE i rekomanduar ka plotësuar Pjesën C: Formularin e Tenderit me shifra dhe me fjalë dhe se e ka shkruar me kompjuter çmimin e ofertës 2,618,594.38 Euro. Te Përshkrimi i çmimit nuk ka cekur që vlera është në euro, por pasi e ka cekur në Formularin e Tenderit, mendojmë se kjo e vërteton që është në rregull.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar nuk ka: Certifikatë të nr.fiskal, dhe Certifikatën e TVSh-së.

Eksperti i OSHP-së sqaron se në dosjen e tenderit është gjetur:

- a) Certifikata e Regjistrimit të Personit të Tatueshëm (shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar) e lëshuar nga Ministria e financave me datë 12.03.2018 me nr.SN-492177-10-17, dhe
- b) Licenca nga Ministria e Transportit sipas Kategorive që OE mund ti kryej punët (NP-1,NP-2,...NP-12; NS-1, NS2,NS-3....NS-20.

Kurse sa i përket Certifikatës së nr.fiskal dhe certifikatës së TVSH-së, AK gjatë procedurës së rivlerësimit, mund t’ia kërkoj OE të propozuar këto dokumentë pasi që kërkojen sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, dhe Pikës 39.8 të RrUOPP-së, që AK mund ti kërkoj OE këto dokumente.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

**Pretendimi ankimor i OE** ankues në lidhje me marrëveshjet dhe licencat e OE që OE i propozuar ka marrëveshje për rrëre dhe zhavore, material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë të asfaltit, mirëpo pas qasjes që kemi pasur:

- Marrëveshja apo kontrata e nënshkruar në mes të “BES Group” e shndërruar nga ish “AHN Group” iu është bashkangjitur licenca nga KPMM-ja për bazën e asfaltit.
- Me tu shndërruar ky biznes nga “AHN Group” në “BES Group” është dashur që edhe licenca e cila është dhënë në shfrytëzim “AHN Group”-it të transferohet në “BES Group”gjithmonë duke u rrespektuar procedurat ligjore të KPMM-së , sepse licenca i është dhënë në shfrytëzim “AHN Group”-it dhe jo “BES Group”-it, sepse edhe nr.biznesit gjatë shndërrimit/ndryshimit të emrit të kompanisë ndryshojnë po edhe nr.fiskal, tvsh etj.

### **Përgjigje në pretendimin e tretë ankimor**

Eksperti i OSHP-së sqaron se kriteri i kërkuar sipas AK në njoftim për kontratë dhe në FDT kriteri i kërkuar për Licencën ose Lejen e lëshuar nga KPMM-ja është kërkuar:

<b>Kerkesa:</b> 6/ Licence-leje të lëshuar nga KPMM-ja ose kontratë nga një ndërmarrje e licensuar nga KPMM-ja (për rrëre dhe zhavorre, material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë e asfaltit)	<b>Deshmia:</b> 6/ Licence-leje të lëshuar nga KPMM-ja ose kontratë nga një ndërmarrje e licensuar nga KPMM-ja (për rrëre dhe zhavorre, material nga guroret, bazë të betonit dhe bazë e asfaltit) (kopje)
---	---

Në dosjen e tenderit të OE së rekomanduar kemi shikuar marrëveshjet që ka pasur OE i rekomanduar me OE-të që e kanë mbështetur për ekzekutim si “AHN Group”, por marrëveshja është bërë si “BES Group” ku OE ankues “Euroasphalt” shpik ka bashkangjitur **vendimin shpjegues të ATK-së**

Nr.02/2016 (procedurat për transferimin e pronësisë tek ndryshimi në formën e biznesit), dhe linkun

<https://kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2017/09/Aplikacioni-per-transfer-Licence-shq.pdf>, ky link lidhet me Ligjin për Miniera dhe Minerale Nr.03/L-163, Neni 10.2 si dhe neni 7 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet thotë:

“Nëse bartësi i licencës për Hulumtimin e licencës ose bartësi i një leje dëshiron të bëjë bartjen e licencës ose Lejes në fjalë, Bartësi i kësaj licence ose leje dhe pranuesi i propozuar i saj duhet që bashkarisht të dorëzojë në KPMM një kërkesë të plotësuar në formën e paraparë së bashku me taksën e paraparë, si dhe ti bashkangjiten disa dokumente e që mund ti gjeni në linkun e lartëshënuar në faqen 3 dhe 4.

**Eksperti i OSHP-së** sqaron se në dosjen e tenderit të OE së propozuar në lidhje me pretendimin e OE ankues, ku OE i propozuar ka marrëveshje për furnizim me të gjitha llojet e asfaltit e nënshkruar me dt.07.03.2018 në mes të OE.”4 A-M” shpk dhe “BES GROUP” shpk, marrëveshja e ka të bashkangjitur LEJEN PËR AKTIVITETE TË VECANTA me nr.452/KPMM/2015, por bartësi i lejes në fjalë nuk është “BES GROUP” shpk, por “AHN Group” shpk nga Fushë Kosova, dhe afati i skadencës së kësaj leje është 21.10.2018(nr. Lejes 452/KPMM/2015)., ku e ka të bashkangjitur një vërtetim nga ARBK që thotë se: “Vërtetojmë se biznesi i regjistruar me dt.29.10.2008 me nr.biznesit 70537362 “AHN GROUP” shpk ka ndryshuar emërtimin si “BES Group” dhe pronar është Besim Bujupi me nr.personal 1010827619.

*Sqarim: Licenca e shfrytëzimit për “BENITA COMPANY” shpk “Furnizim me gurë”(shkëmb të fortë) ka validitet deri 14.09.2020, Licenca për Furnizim “BENITA COMPANY” shpk për Furnizim me beton ka pasur afat në ditën e hapjes, por i ka skaduar afati me dt.08.06.2018 (nr. Lejes 432/KPMM/2015).*

*Licenca për Rrë dhe Zhavorr me “DREONI” shpk ka pasur afat në ditën e hapjes por i ka skaduar me dt.05.06.2018 (nr. Lejes 1679/KPMM/2017)..*

*Licenca për Furnizim me asfalt e bartësit “AHN GROUP” shpk(nr. Lejes 452/KPMM/2015)., por marrëveshja është bërë me “BES GROUP”, pasi që sipas vërtetimit të ARBK-së të dt.07.07.2017 që gjendet në dosjen e OE-se propozuar, vërtetohet se është ndërruar pronari nga “AHN Group” në “BES Group”, mirëpo ka qenë dashtë të bëhet bartja me dokumente dhe licenca të merret si “BES Group” shpk.*

Duke u bazuar në keto dëshmi që i ka pasur në dispozicion Eksperti i OSHP rezulton se OE i rekomanduar për kontratë, nuk e plotëson kërkesën e lartepërmendur në lidhje me Licencën nga KPMM-ja.

Pretendimi ankimor i bazuar.

### **Pretendimi i katert ankimor i OE ankues**

OE ankues pretendin në lidhje me Qarkullimin bankar se OE i propozuar nuk ka arritur të dëshmojë qarkullimin financiar (bankar) prej 7,000,000 €.

Kërkesa e AK-KK.Gjakovë sipas FDT-së është:

2/Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 7.000,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

2/ Vërtetimi nga banka ose raport bankar i nënshkruar dhe vulosur i cili dëshmon se qarkullimi bankar i kërkuar në periudhën e tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë është i plotësuar sipas kërkesës.

**Eksperti i OSHP-së** sqaron se OE i rekomanduar për kontratë “4 A-M” shpk ka të bashkangjitur një Listë të punëve të ngjashme për 3 vitet e fundit, ku në këtë listë ka të vendosura Emrat e projekteve që i ka kryer projektet për periudhën 2013,2015,2016,2017 dhe 2018.

Po i paraqesim disa projekte që i ka të futur në listë OE i propozuar:

1. Ndërtimi i trotuareve dhe rrugëve përreth ndërtesës qendrore të bankës së Shqipërisë – Banka e



- Shqipërisë – 20.04.2015-10.07.2015 ku vlera e projektit është 32 809 123 ALL ose 249,000 Euro;
2. Rehabilitimi rruga “Dermish-Dhiver – Cerkovice” – Bashkia Finiq, Shqiperi – 10.01.2017-10.04.2017, ku vlera e projektit është 98,010,486 ALL ose 744,930 Euro
  3. Rehabilitimi rruga Burbullaj – Bashkia Lezhë – 19.01.2017 – 20.03.2017, ku vlera e projektit është 29,072,760 ALL ose 220,900 Euro
  4. Ndërtimi i rrugës Binisht – Baqel, - Bashkia Lezhë – 19.01.2017 – 20.03.2017, ku vlera e projektit është 32,628,360 ALL ose 248,000 Euro
  5. Ndërtimi i unazës së re të Tiranës – KARL Gega Konstruktion – 04.10.2013-10.10.2016, ku vlera e projektit 350,000,000 ALL ose 2,660,000 Euro;
  6. Plotësimi dhe përfundimi i ndërtimit të unazës së re të Tiranës – Bashkia Tirannë, Shqipëri – 20.03.2017 – 12.02.2018, ku vlera e projektit është 1,049,558,422 ALL ose 7,977,186.45 Euro.

Në dosjen e tenderit ka qarkullimin bankar ka një Vërtetim lidhur me qarkullimin bankar nga BKT e dt.29.03.2018, ku shënon Vërtetim lidhur me qarkullimin bankar të shoqërisë “4 A-M” SHPK, dhe qarkullimi është:

1. Për vitet 2015 me shumë prej 255,152,468 LEK
2. Për vitin 2016 në shumë prej 581,883,229 LEK
3. Për vitin 2017 në shumë prej 1,246,370,000 LEK
4. Për vitin 2018 në shumë prej 35,032,413 LEK

Mendojmë se sipas listës së projekteve që i ka bashkangjitur me vlera dhe vërtetimit të qarkullimit bankar, AK-KK.Gjakovë gjatë rivlerësimit të kalkuloj konvertimin sipas kursit të Lekut.

Pretendimi pjesërisht i bazuar.

#### **Pretendimi i pestë ankimor**

OE ankues në pretendimi ankimor ne lidhje me Licencën e organit që ka kryer auditimin e pasqyrave financiare!

Në Njoftimin për kontratë dhe në FDT kërkesa e AK-së është:

1/Pasqyrat e audituara ne tri vitet e shkuara	1/Kopja e pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e shkuara dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë Kompani e Auditimit – (Të bashkangjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit)
---	---

**Eksperti i OSHP-së** ne dosjen e ankuesit vërteton se ka të bashkangjitura LICENCËN për AUDITUES LIGJOR të noterizuar si:

- 1) Licenca për Auditues Ligjor , Licenca është lëshuar sipas Vendimit të Komitetit të Regjistrimit nr.24, datë 11.01.2000 në emër të Leze Tom Abazi, Licenca është lëshuar me datë 31.03.2017 në Tiranë – e noterizuar me datë 27 mars 2018 (Noter – Gerta Begolli);

Pasi që kërkesa e AK-së është : Raporti i Auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar apo Ndonjë Kompani Licencimi.

OE ankues në dosjen e tenderit e ka licencën për auditorin.

Pretendimi ankimor i pabazuar

#### **Pretendimi i gjashtë ankimor**

**Pretendimi i OE ankues** në lidhje me inxhinierin se nuk është sipas kërkesës së AK

- Inxhinieri i vendosur në listën e OE. “4 AM” Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë i kërkuar të drejtimit

konstruktiv apo infrastrukturë rrugore, nuk është askund me personin që e ka vendosur “Bujar Kurti”, pasi që drejtimi i këtij inxhinieri është inxhinier për ndërtime industriale – ura e që nuk është e njëjtë ashtu sic është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

### **Përgjigje në Pretendimin ankimor**

Eksperti shqyrtues sqaron se kriter i kërkuar i AK-së ka qenë:

<b>2/ Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i Inxhinierisë së ndërtimit (drejtimi Konstruktiv apo Infrastrukturë Rrugore)</b>	<b>2/ Listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore.</b>
--	--

OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur Diplomen e një inxhinier për ndërtime industriale civile-ura.

Diploma me nr. serik 2089-8 e e lëshuar për z. Bujar Kurti, inxh. për ndërtime industriale civile – ura. Injēti person (Bujar Kurti) ka të bashkangjitur **licencë me nr. Z.0095/5** e datës 29.10.2005 e lëshuar nga Ministria e Punëve dhe Transportit e Republikës së Shqipërisë- Komisioni për dhënien e Licencave. (Licenca është e lëshuar për këto kategori: Germime dheu, prodhim materiale inerte, prodhim të elementeve të betonit, ndërtime civile-industriale, ndërtim banesa me skelet mbi 8 kate, ndërtim rruge kategoria IV dhe V, Ndërtim ura dhe vepra arti deri 10 metra, ndërtim për ujësjellës dhe kanalizim)

Edhe pse në licencën e inxhinierit Bujar Kurti ekziston ndërtim rruge kategoria IV dhe V, Ndërtim Ura dhe vepra arti deri 10 m, ne mendojmë se mund të merret si diplomë e ngjashme, por nuk është e njëjtë me kriterin e kërkuar të AK-së “Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i Inxhinierisë së ndërtimit (drejtimi Konstruktiv apo Infrastrukturë Rrugore)”. Edhe pse kjo ka mund të qartësohet dhe vërtetohet përmes programeve studimore që ka shkollimi universitar sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që kërkesë e AK-së nuk ka qenë që diploma e inxhinierit të jetë e ngjashme.

Pretendimi pjesërisht i bazuar

### **Pretendimi i shtatë ankimor**

Pretendimi ankimor i OE ankues, sa i përket makinerisë mjeteve – pajisjeve teknike për realizimin e kontratës në fjalë OE i rekomanduar për kontratë “4 AM” nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme lidhur me:

- Katër (4) eskavator me peshë totale prej min 13 T, nuk ka dëshmi dhe dokumentacion të pastër që dëshmon, pra edhe pas shiqimit të dokumenteve dhe verifikimit të këtyre pajisjeve/mjeteve kemi hulumtuar në internet dhe kemi vërtetuar se disa prej këtyre mjeteve nuk kanë mundësi të peshës min. 13 T,
- Gjashtë (6) kamionët e prezantuar nuk ka dëshmi të mjaftueshme se kanë konstruksion-ndërtim kiper ashtu sic është kërkuar në dosjen e tenderit,
- Dy (2) kamionët e prezantuar nuk kanë dëshmi të mjaftueshme se kanë konstruksion-ndërtim auto mikser të betonit me peshë totale prej 16 T ashtu sic është kërkuar në dosjen e tenderit,
- Një kamion i prezantuar nga OE “4 AM” nuk ka dëshmi se ka konstruksion- ndërtim me auto pompë për betonim me peshë totale min. 16 T ashtu sikur që është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

### **Përgjigje në pretendim ankimor**

Eksperti shqyrtues i OSHP-së sqaron se sa i përket listës së mjeteve sipas kërkesave të AK-së, Operatori i propozuar për kontratë në dosjen e tij i ka të bashkangjitur:

4-eskavator me DUD-a dhe fatura, 6 kamion kiper, por edhe e ka një marreveshje me qira e nënshkruar dhe vulosur me datë 27.03.2018 në mes të BIBA-X” shpk me NIPTI: K 32618815 N dhe “4 A-M” shpk me NIPT K 92005016L për marrjen e mjeteve me qera:

- 1 .Asfaltshtruese (finisher);
- 2.Autobetonjere me targa KJ 9564 A (automikser);
- 3.Autobetonjere me targa KJ 9417 A (automikser);
4. Autopompe betoni me targa KJ 8824 A

Eksperti i OSHP-së bazuar në dokumentet e bashkangjitura OE i propozuar e plotëson kriterin e kërkuar nga AK, dhe pretendimi ankimor është i pabazuar.

....

#### **Pretendimi i tetë ankimor**

Lidhur me pretendimin ankimor e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë konkretisht prodhuesi SHNEIDER ELECTRIK nuk ka lëshuar autorizim por ka lëshuar deklaratë për kompanin A BI ESSE, Eksperti i OSHP-së sqaron se prodhuesi SHNEIDER ELECTRIK ka lëshuar një deklaratë për ABI ESSE, në të cilën deklaratë shkruan se kompania A BI ESSE është distributor zyrtar i prodhuesit SHNEIDER. Eksperti i OSHP-së sqaron se OE mbulon kërkesën në lidhje me autorizimin, pasi që kjo mund të quhet devijim i vogël sipas nenit 59.4 i cili nuk ndikon në aspektin material dhe ndryshimet teknike substanciale të ofertës.

Lidhur me pretendimin e katalogut të OE ankues për prodhuesin V-TAC

Eksperti i OSHP-së, sqaron se në fletën e katalogut OE i propozuar nuk e plotëson kriteret e kërkuara sipas specifikimit teknik.

OE i propozuar për kontratë ka ofertuar me produktet V-TAC, qe kriter ka qenë që efekti i ndriqeshmërisë të jetë  $\geq 170$ , pa mund të jetë më e madhe ose e barabartë me 170 lm/W.

Eksperti i OSHP-se sqaron se: Në katalogun e bashkangjitur te OE se rekomanduar ka nje Letër autorizim, certifikate konformiteti nga V-TAC

Sa i perket specifikimit te dhene ne dosjen e tenderit dhe specifikacionit te ofruar nga OE i rekomanduar ne dosjen e tenderit te pozicioni 5.0.8 Trupi ndriqes, nuk perputhet me kriteret qe i ka kerkuar AK-ja.

Këtë mangesi te OE se propozuar e verteton edhe vet AK ne kerkesen per informata shtese dt.14/05/2018 qe i ka bere OE se rekomanduar ku thote se (citim): “Katalogu i prezantuar nga ju (OE “4 A-M”) per llampat e ndriçimit V-TAC nuk i plotëson specifikat minimale sa i perkete efikasitetit te ndriqeshmerisë i cili duhet të jetë jo më i madh ose i barabartë me 170 lm/W”. Kërkojme sqarime shtese sipas nenin 72.

Edhe kerkese e AK ka qene qe trupi ndriqes te jete ne harmoni me standardet Evropiane, EN 60598-2-3, EN 55015, EN 1547:2009, EN 61000-6-2: 2005: EN 61000-6-3:2007, Temperature Pune -40...+60

Pra, edhe me standardet e kerkuara nga AK-ja produkti i prezantuar nga OE i propozuar nuk i permbush standardet sic i ka kerkuar AK.

Sipas informatave shtese qe i ka kerkuar AK-ja nga OE i rekomanduar, me katalogun shtese disa i permbush e disa nuk i permbush psh. Kriteri qe trupi ndriqes te jete ne ne Harmoni me standardet Europiane EN 60598-2-3, EN 55015, EN 1547:2009, EN 61000-6-2: 2005: EN 61000-6-3:2007, Efikasiteti i ndriqeshmerisë  $\geq 170$ , Temperature Pune -40...+60 . pra edhe sipas certifikates se konformitetit nga V-TAC, ku jane te paraqitura standardet:

**EN 60598-1:2008+A11:2009;**

EN 60598-2-2:1996+A1:1997;

EN 62031:2008

EN 61347-1:2008+A1:2011

EN 61347-2-13:2006;

EN 62471:2008

EN 62493:2010

OE i propozuar nuk i përmbush keto karakteristika të kërkuara nga AK.

Edhe pse në këtë rast OE e ka sjellur katalogun siç e ka kërkuar AK, por OE i rekomanduar ka sjellur deshmite që nuk e përmbush kriterin e kërkuar të AK.

Pra, bazuar në Piken 39 të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, ku thotë:

Është dorëzuar katalogu për mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm	69
--	---	----

Bazuar në RrUOPP-se nëse Është dorëzuar katalogu për mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe nuk përmbushet kriteri i kërkuar nga AK-ja, thotë Refuzo Tenderit pa kërkuar informata shtesë – neni 69.

Pra, ky kriter i kërkuar nga AK, nuk përmbushet nga OE i rekomanduar.

Pretendimi ankimor i bazuar.

#### **Pretendimi i nëntë ankimor**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se në dosjen e OE-së së propozuar mungon certifikata e prodhuesit EN për Tamburrini Alessandro.

Eksperti i OSHP-së sqaron se në dosjen e tenderit gjindet një certifikatë garancie e lëshuar nga TAMBURRINI ALESSANDRO në dy gjuhë (italisht dhe shqip). TAMBURRINI ALESSANDRO ka lëshuar Certifikatë për “IDK-Konstruksion” shpk, ku deklaron se: “Produktet tona të sinjalistikës rrugore vertikale dhe aksesore të ndryshëm” të ofruara nga distributori ynë zyrtar në Shqipëri, shoqëria “Idk-Konstruksion” shpk janë konform normave të komunitetit europian, ISO 9001:2008 dhe kanë një garanci prej 11 vjet.

Kriteri i kërkuar i AK-së:

6/ Të gjitha produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN - të ofrohen certifikata për për standardet EN të produkteve të ofruara.	6/ Produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN (Produktet e ndriçimit publik dhe sinjalizimit janë të specifikuar në pozicionet e paramasës së projektit), - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara.
---	---

Përfaqësuesi i autorizuar “IDK-KONSTRUKSION” shpk, ka të bashkangjitur Certifikatën EN-ISO 9001:2015, me nr.AQS/Q/18352017 e datës 10/05/2017 me afat të skadencës 09/05/2020

*Certifikata është lëshuar për: “projektim, ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të objekteve civile, industriale dhe infrastrukturore (ndërtesa, rrugë, autostrada, mbikalime, punime nëntokësore, ura, vepra arti etj).*

Sipas certifikatës së garancisë së lëshuar nga prodhuesi TAMBURRINI ALESSANDRO, vërteton se IDK-KONSTRUKSION është distributor për produktet e TAMBURRINI ALESSANDRO, atëherë certifikata EN të kërkohet për prodhuesin, që në rastin konkret prodhuesi nuk e ka bashkangjitur certifikatën EN, por sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkohet certifikata në fjalë.

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE mbulon kërkesën në lidhje me autorizimin, pasi që kjo mund të quhet devijim i vogël sipas nenit 59.4 i cili nuk ndikon në aspektin material dhe ndryshimet teknike substanciale të ofertës.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

#### **Pretendimi i dhjetë ankimor**

Pretendimi i OE ankues se nuk ka dëshmi se prodhuesi **Vernisol** ka lëshuar **“AUTORIZIM”** për kompanin “IDK Construction”, në ofertën e kompanisë “4 AM” është një dokument i titulluar “CERTIFICATO DI GARANZIA” dhe e perkthyer në gjuhën shqipe “CERTIFIKATE GARANCIE”, dhe nuk është askund autorizimi, dhe është në kundërshtim me kërkesën e AK të cekur në pozicionin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së ku kërkohet dokumenti AUTORIZIM dhe jo Certifikatë.

#### **Përgjigje në pretendimin ankimor**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se prodhuesi “VERNISOL” me datë 07.01.2018 ka lëshuar një Certifikatë garancie për “IDK-KONSTRUKSION” i cili me këtë deklaron se: “produktet tona Bojera dhe aksesoreve per sinjalistiken rrugore” të ofruara nga IDK-KONSTRUKSION, distributori ynë zyrtar në Shqipëri, janë konform normave të komunitetit europian , ISO:2008, dhe kanë një garanci 2 vjet.

Sipas certifikatës së garancisë së lëshuar nga prodhuesi VERNISOL, vërtetohet se IDK-KONSTRUKSION është distributor zyrtar në Shqipëri për produktet e VERNISOL-it, atëherë certifikata EN të kërkohet për prodhuesin, që në rastin konkret prodhuesi nuk e ka bashkangjitur certifikaten EN, por sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkohet certifikata në fjalë.

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE mbulon kërkesën në lidhje me autorizimin, pasi që kjo mund të quhet devijim i vogël sipas nenit 59.4 i cili nuk ndikon në aspektin material dhe ndryshimet teknike substanciale të ofertës.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

#### **Pretendimi i njëmbëdhjetë ankimor**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK- KK.Gjakovë duhet te respektoj nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39.8 te RrUOPP-së dhe te kerkoj informata shtese .

Eksperti i OSHP-së sqaron se AK, duhet të respektoj nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së, dhe Pikën 39.8 të RrUOPP-së sipas rekomandimeve të dhëna në ekspertizë.

#### **Pretendimi i dymbëdhjetë ankimor**

Pretendimi i OE ankues se në raportin e vlerësimit të tenderit të AK-së, komisioni i vlerësimit i përbërë nga 3 anëtar, nga ky komision vetëm 2 anëtarët e kanë nënshkruar raportin (Ilhamije Kumnova, Lekë Sina), kurse kryesuesi i komisionit të vlerësimit Hysen Merovci – Zyrtar i Ministrisë së Infrastrukturës (nuk e ka nënshkruar fare raportin)

AK-KK.Gjakoves nuk e ka publikuar edhe vendimin për Autoritetin Kontraktues sipas pikës 43.7 dhe 43.8 të RrUOPP-së ku thotë se:

43.7 AK përpos letrave njoftuese standarde të shënuara më lartë, duhet që të përgatitë “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” dhe ta ngritë në platformë të prokurimit elektronik si dokument shtesë nëpërmjet funksionit “shtoni dokument të ri”.

43.8 AK duhet që “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” ta ngritë në platformë dhe në të njëjtën ditë t’i lëshojë letrat njoftuese.

Lidhur me vlerësimin e procedurës vetëm dy anëtarë komisioni e kanë nënshkruar raportin, ndersa nuk e ka nënshkruar kryesuesi i komisionit.

Eksperti i OSHP-se sqaron se komisioni i vlerësimit i përbërë nga 3 anëtar, nga ky komision vetëm 2 anëtarët e

kanë nënshkruar raportin (Ilhamije Kumnova, Lekë Sina), kurse kryesuesi i komisionit të vlerësimit Hysen Merovci (nuk e ka nënshkruar fare raportin).

Këtë e sqaron Pika 40 e RrUOPP-se (vlerësimi, krahasimi dhe ekzaminimi) që e qarteson procedurën e vlerësimit konkretisht, pika 40.4 dhe 40.5 e RrUOPP-së:

**40.4 thotë: “Zyrtari përgjegjës i Prokurimit nuk do të shërbej si anëtarë i komisionit vlerësues. Anëtarët e stafit të Departamentit të Prokurimit mund të shërbejnë si anëtarë të komisionit vlerësues. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP, ndersa**

**Pika 40.5 thotë: “Numri i anëtarëve të komisionit vlerësues do të varet nga vlera dhe kompleksiteti i aktivitetit të prokurimit, por në të gjitha rastet do të përbëhet nga jo më pak se (3) tre dhe numri gjithnjë do të jetë tek”. Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit. Personat të cilët kanë qenë anëtarë të komisionit për hapje të ofertave mund të jenë anëtarë të komisionit vlerësues.**

AK-KK.Gjakove vetëm me dy anëtarë të komisionin e ka kryer vlerësimin dhe ka bërë shpalljen e fituesit, ku qarte e precizon udhezuesi se duhet të jene jo me pak se 3, kurse ne raport gjinden vetem 2 nënshkrime.

Pretendimi ankimor i bazuar.

## **Ankesa e OE ankues 279/18 “Mirusha Company” shpk – Klinë**

### **Pretendimin e parë ankimor**

**Lidhur me pretendimin e OE ankues se nga AK-KK Gjakovë :** Sa i përket pretendimit ankimor të AK që ne nuk kemi ofruar dëshmi për një finisher siq është kërkuar në dosjen e tenderit, ne kemi dorëzuar me datën 16.05.2018 dokumente/informata shtesë: Marrëveshjen për dhënie me qera ndërmjet “Granit Com” shpk dhe “Ispe Com” shpk, ku këto dy kompani me datën 03.01.2018 e kanë arritur marrëveshjen për dhënien me qera të mjeteve dhe stabilimenteve në afat të caktuar nga 03.01.2018 deri 31.12.2018, ky pretendim duhet të hudhet poshte nga që finisheri i prezantuar në dosjen e tenderit është në listën e pajisjeve të Ispe Group shpk me të cilin kemi marrëveshje për Furnizim me asfalt.

Tek qeshtja e autorizimeve ne kemi dorëzuar me datën 16.05.2018 Autorizim nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi për sinjalizim horizontal dhe vertikal me kompanin Malesia bashkangjitur është dorëzuar katalogu edhe ne gjuhen shqipe bashke me foto percjellese edhe ky pretendim është i paqëndrueshem.

Poashtu edhe ne dosjen e tenderit ne kemi dorëzuar katalogun nga kompania Bau Produktet për prodhimet e pajisjeve elektrike dhe trupave ndriçues por për shkak të vëllimit të madhe të dokumenteve të dorëzuara me Dorezim të informacioneve shtese, katalogu nuk është dorëzuar prap me informata shtese.

EN standarde e produkteve si për sinjalizim horizontal dhe vertikal si dhe për pajisjet elektrike dhe trupave ndriçues i kemi dorëzuar në dosjen e tenderit poashtu edhe EN standarde kompanisë sonë ne i kemi dorëzuar, pastaj më nuk na është kërkuar të dorëzojmë prap me informata shtesë.

### **Pergjigje ne pretendimin e pare ankimor**

**Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues lidhur me listën e mjeteve**

Eksperti i OSHP-së sqaron se OE ankues ka të bashkangjitur listën e mjeteve në emër të OE. “ISPE Group”, ku në listë e ka të përshkruar Finisher, dhe ekziston marrëveshja për furnizim me asfalt e nënshkruar me ISPE GROUP dhe Mirusha Company, ku në nenin 2 të marrëveshjes ceket se ISPE është i obliguar të beje furnizimin me asfalt sipas kërkesave dhe nevojave të Mirusha Company si dhe me gjithë mekanizmit e nevojshem për perfundimin e projektit.

Ne informatat sqaruese që OE ia ka pecjellur AK-së me dt.16.04.2018, me këtë OE e dëshmon se OE. “ISPE”

dhe OE. "Graniti Com" me date 03.01.2018 kanë një marrëveshje për dhenie me qera të makinerisë, në këtë marrëveshje ka të paraqitur: Finisher VOGELE 1704, Valaku HAMM DV 7 (cilinder-goma) dhe Valaku HAMM DV 7 (cilinder-cilinder), po në këtë marrëveshje është paraqitur edhe çmimi i qerasë.

Po me informatat e njëjta shtesë janë paraqitur edhe deshmi për eskavatorët siç i ka potencuar OE ankues (Eskavator PC-340-viti 2000, Eskavator Hyundai modeli R 290 LC-7A (H0377) viti 2007 dhe VALAK Bomag BV 100 viti 1999).

Pra OE ankues në pretendimin ankimor për mjetet e plotëson kriterin e kërkuar nga AK-ja.

Pretendimi ankimor i bazuar.

### **Pretendimi i dytë ankimor**

Në lidhje me pretendimin ankimor për Licencat dhe marrëveshjet e kërkuara

**Eksperti i OSHP-se** sqaron Licenca e shfrytëzimit për "BENITA COMPANY" shpk "Furnizim me gurë" (shkëmb të fortë) ka validitet deri 14.09.2020, Licenca për Furnizim "BENITA COMPANY" shpk për Furnizim me beton ka pasur afat në ditën e hapjes, por i ka skaduar afati me dt.08.06.2018 (nr.Lejes 432/KPMM/2015).

Licenca për Rrë dhe Zhavorr me "DREONI" shpk ka pasur afat në ditën e hapjes por i ka skaduar me dt.05.06.2018 (nr.Lejes 1679/KPMM/2017)..

Licenca për Furnizim me asfalt e bartësit "AHN GROUP" shpk (nr.Lejes 452/KPMM/2015).., por marrëveshja është bërë me "BES GROUP", pasi që sipas vërtetimit të ARBK-së të dt.07.07.2017 që gjendet në dosjen e OE-se propozuar, vërtetohet se është ndërruar pronari nga "AHN Group" në "BES Group", mirëpo ka qenë dashtë të bëhet bartja me dokumente dhe licenca të merret si "BES Group" shpk.

OE ankues deklaroi se ka kërkuar sqarim nga KPMM-ja lidhur me licencën, Përmes Arkivit KPMM-ja është përgjigjur për kërkesën tone si më poshtë:

**Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale** e ka pranuar kërkesën tuaj lidhur me informata për ndërmarrjen "AHN Group" shpk me nr.biznesit 70537262, informatat janë kërkuar me qëllim të njohjes se a posedon kjo ndërmarrje Licencë/Leje në KPMM.

KPMM me anë të inspektoratit kanë inspektuar terrenin, janë marrë koordinatat e vendit ku ka qenë e vendosur fabrika e prodhimit të asfaltit – Baza e asfaltit e Ndërmarrjes "AHN-Group" shpk si dhe janë bërë foto me qëllim që gjendja e krijuar në terren të paraqitet sa më reale.

Gjatë inspektimit në terren Inspektorët e KPMM-së kanë konstatuar se fabrika e prodhimit të asfaltit e ndërmarrjes "AHN Group" ishte çmontuar dhe zhvendosur nga lokacioni për të cilën ka poseduar leje për aktivitete të veçanta.

KPMM ju njofton se kjo ndërmarrje nuk posedon më Fabrikën për prodhimin e Asfaltit në vendin Miradi e Ulët, KK Fushë Kosovë dhe nuk ka leje për aktivitete të veçantë Bazë Asfalti dhe e njëjta nuk mund të shfrytëzojë Lejen për Aktivitete të Veçanta me nr.452/KPMM/2015.

Në mënyrë që të pajiset me leje kjo ndërmarrje duhet të aplikojë në KPMM në Pajtim me Ligjin për Minierat dhe Minerale.

Duke u bazuar në këtë deshmi që i ka pasur në dispozicion Eksperti i OSHP rezulton se OE i rekomanduar për kontratë, nuk e plotëson kërkesën e lartpërmendur në lidhje me Licencën nga KPMM-ja për Bazën e asfaltit.

Pretendimi ankimor i bazuar.

## ANKESA 283/18 OE ankues “DRINI COMPANY”

### Pretendimi i parë i OE ankues lidhur me Formularin e Tenderit – Pjesa C

#### Përgjigje në pretendimin e parë ankimor

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar nuk e ka të plotësuar Formularin e Tenderit - Pjesa C, nuk qëndron për faktin se OE i rekomanduar në formularin C ka të plotësuar pikën 3 (çmimi total i tenderit) ku e ka vendosur çmimin me shifra dhe fjalë, në pikën 4 ku ne te OE e ka plotësuar validiteti i tenderit, në pikën 5 OE e ka plotësuar vlerën e sigurisë së ekzekutimit, në pikën 6 të Pjesës C ka shënuar emrin e OE dhe nacionalitetin, poashtu OE i propozuar ka plotësuar Identifikimin e Operatorit Ekonomik, që e ka plotësuar, nënshkruar dhe vulosur. Pra, të gjitha elementet që duhet të plotësohen OE i ka plotësuar edhe PJESEN C edhe Paramasen e ofertes, dhe te dy pjeset i ka te nënshkruara dhe vulosura siç kërkohen nga AK-ja.

OE ankues me datë 20.06.2018 ka kërkuar interpretim nga Departamenti i rregullave nga KRPP-ja, dhe po të njëjtën ditë, ky Departament i KRPP-së i kthen interpretimin ku thotë (citim): ...nga tenderuesi kërkohet të plotësohen si dhe të nënshkruhen, aty ku kërkohet në këtë formular. Per me teper me kete nenkuptojme se Tenderuesit as AK nuk i lejohet të bëjë ndërhyrje tekstualisht në përmbajtjen e këtij formulari qe do e rezultonte me ndryshimin e përmbajtjes se tij, ose duke mos i ofruar te gjitha informatat qe kerkohen ne kete formular.

Ne RrUOPP neni 39 thotë :

Formulari i tenderit nuk eshte plotesuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kerkuar informacion te me tejshem	Kusht administrativ
--	--	---------------------

Bazuar në këtë kuptojmë se Nese nuk eshte plotesuar Formulari i Tenderit siç duhet apo mungon, AK mund ta refuzoj, por nga Formulari i plotesuar, nënshkruar dhe vulosur kuptojme se te gjitha pozicionet qe kerkohen te plotësohen OE i rekomanduar i ka plotësuar.

Sa i përket plotësimit apo mosplotësimit të Header dhe Footer, këto janë leshime teknike qe ndodhin dhe nuk ndikon në aspektin material te tenderit. Ky rast mund të trajtohet si “Devijim i vogël” sipas nenit 59.4 te LPP-së:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pra bazuar në nenin 59.4 të LPP-së OE i rekomanduar për kontratë Formularin e Dorezimit të Tenderit – Pjesën C e ka të plotësuar dhe nënshkruar ashtu siç edhe kërkohet nga AK-ja.

Pretendimi ankimor i pabazuar.

#### Përgjigje në pretendimi i dytë ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se kriteri i kërkuar i AK ka qenë:

Ne DT pika 9.1 dhe 9.2 . Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale



**-OE duhet te dorezoj autorizimin original te prodhuesit ose dilerit per pajisje elektrike ose trupat ndriqes.**

**-Deshmia e kerkuar dokumentare autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi per pajisje elektrike dhe trupa ndriqes. (me te cilen prodhuesi-perfaqesuesi, e autorizon operatorin per furnizim me pajisje elektrike dhe trupa ndriqes si dhe katalog te detajuar).**

Në dosjen e tenderit të AK janë kërkuar këto specifika për produktet si në pikën 5.0.8 dhe 5.0.9

5.0.8	<p>Trupi ndriqes - Llamba komplet kompakte e LED teknologjis</p> <p>Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë. Llamba nga aspekti i dizajnit dhe kualitetit duhet ti plotësoj standardet Evropiane, EN 60598-2-3, EN 55015, EN 1547:2009, EN 61000-6-2: 2005: EN 61000-6-3:2007 dhe të ketë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtje mekanike; IP65 (IP66)</li> <li>• Qëndrueshmëri pune: <math>\geq 100\ 000</math> (h/pune)</li> <li>• Efikasitet të ndriqeshmërisë: <math>\geq 170</math> lm/W</li> <li>• Në 50 000 (h/punë) të LED-it : L85/B20</li> <li>• Temperaturë të ngjyrës: <math>\leq 4000</math>K</li> <li>• Tension pune: 90...205 V (50Hz)</li> <li>• Faktor të fuqisë: <math>\geq 0.97</math></li> <li>• Temperaturë pune: <math>(-40 \dots +60)^{\circ}\text{C}</math></li> <li>• Mbrojtje në goditje: IK08</li> <li>• Me xham të rrafshët të temperuar me trashësi 4 mm si dhe rrezistent në teperaturë (EN 12150 +12001)</li> <li>• Me kënd të rrotullimit <math>\pm 15^{\circ}</math></li> <li>• Garancioni: <math>\geq 10</math> vite.</li> </ul> <p>Llamba komplet kompakte e LED teknologjis me fuqi 150 W</p>	copë	110.00
5.0.9	Furnizimi transporti dhe montimi i ankerave per trupa ndriqes me 4 bulona me dimensione te dhena ne pjesen grafike.	copë	59.00

OE i propozuar për kontratë ka ofertuar me produktet V-TAC, qe kriter ka qenë që efekti i ndriqeshmërisë të jetë  $\geq 170$ , pa mund të jetë më e madhe ose e barabartë me 170 lm/W.

Eksperti i OSHP-se sqaron se: Në katalogun e bashkangjitur te OE se rekomanduar ka nje Leter autorizim, certifikate konformiteti nga V-TAC

Sa i perket specifikit te dhene ne dosjen e tenderit dhe specifikacionit te ofruar nga OE i rekomanduar ne dosjen e tenderit te pozicioni 5.0.8 Trupi ndriqes, nuk perputhet me kriteret qe i ka kerkuar AK-ja.

Kete e verteton vet AK ne kerkesen per informata shtese dt.14/05/2018 qe i ka bere OE se rekomanduar ku thote se (citim):Katalogu i prezantuar nga ju (OE "4 A-M") per llampat e ndriqimit V-TAC nuk i ploteson specifikat minimale sa i perkete efikasitetit te ndriqeshmerisë i cili duhet të jetë jo më i madh ose i barabartë me 170 lm/W. Kerkojme sqarime shtese sipas nenin 72.

Edhe kerkese e AK ka qene qe trupi ndriqes te jete ne harmoni me standardet Evropiane, EN 60598-2-3, EN 55015, EN 1547:2009, EN 61000-6-2: 2005: EN 61000-6-3:2007, Temperature Pune -40...+60

Pra, edhe me standardet e kerkuara nga AK-ja produkti i prezantuar nga OE i propozuar nuk i permbush standardet sic i ka kerkuar AK.

Sipas informatave shtese qe i ka kerkuar AK-ja nga OE i rekomanduar, me katalogun shtese disa i permbush e disa nuk i permbush psh. Kriteri qe trupi ndriqes te jete ne ne Harmoni me standardet Europiane EN 60598-2-3, EN 55015, EN 1547:2009, EN 61000-6-2: 2005: EN 61000-6-3:2007, Efikasiteti i ndriqeshmerisë  $\geq 170$ , Temperature Pune -40...+60 . pra edhe sipas certifikates se konformitetit nga V-TAC, ku jane te paraqitura standardet:

**EN 60598-1:2008+A11:2009;**

**EN 60598-2-2:1996+A1:1997;**

EN 62031:2008  
EN 61347-1:2008+A1:2011  
EN 61347-2-13:2006;  
EN 62471:2008  
EN 62493:2010

OE i propozuar nuk i përmbush keto karakteristika të kërkuara nga AK.  
Edhe pse në këtë rast OE e ka sjellur katalogun siç e ka kërkuar AK, por OE i rekomanduar ka sjellur deshmite që nuk e përmbush kriterin e kërkuar të AK.

Pra, bazuar në Piken 39 të Udhezuesit Operativ të Prokurimit Publik, ku thotë:

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
--	---	----

Bazuar në RrUOPP-se nëse Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe nuk përmbushet kriteri i kërkuar nga AK-ja, thotë Refuzo Tenderit pa kërkuar informata shtesë – neni 69. Pra, ky kriter i kërkuar nga AK, nuk përmbushet nga OE i rekomanduar.  
Pretendimi ankimor i bazuar.

#### **Pretendimi i tretë ankimor**

Pretendimi i OE ankues në lidhje me specifikat teknike për sinjalizim

#### **Përgjigje në pretendim e tretë ankimor**

Eksperti shqyrtues i OSHP-së sqaron se bazuar në pretendimin ankimor të OE ankues se  
Në pikën 6.1.1 të përshkrimit të çmimeve në dosjen e tenderit janë dhënë specifikat teknike për sinjalizim vertikal, ku kërkohen të jenë:

*Tipi i foljes: Diamond Grade, Ndritshmëria ditën: Min 27-luminance, Koeficienti i reflektueshmërisë 580-420-120 Cd/Luxm<sup>2</sup>, Jetëgjatësia e retroreflektimit të folies 1-7 vite 80% ulje reflektive, 8-11 vite 70% ulje reflektive*  
Në kataloget e prezantuara nga OE prodhues TAMBURRINI ALESSANDRO, nuk ka të dhëna teknike për kërkesat e AK. Këta kanë prezantuar vetëm katalog të shenjave e jo të karakteristikave të qëndrueshmërisë sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Gjithashtu edhe në pikën 6.0.1 sinjalizimi horizontal janë kërkuar që produkti të ketë këto karakteristika: “trashësia 2-3 mm me masë dy komponente plastike e ftohtë, tipi i ngjyrës acryl, masa reflektuese swc 100-600 T14:0.25 Kg/m<sup>2</sup>”

Me katalogjet e ofruara OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të plotësojë as minimumin e kërkesave të specifikimit teknik të detyrueshëm këtë me se miri e precizon Pika 39 i RrUOPP-së Rregullave dhe UOPP-se :

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
--	---	----

OE i rekomanduar nuk i ka të bashkangjitura karakteristikat e kërkuara nga AK.

Bazuar në nenin 39 të udhezuesit të RrUOPP-se nuk përmbushet kriteri i kërkuar nga AK-ja.

Pretendimi ankimor i bazuar.

#### Ankesa nr.291/18 OE ankues “KAG ASFALT”

##### Pretendimi i parë ankimor

Kompania KAG Asphalt është shpallur e papërgjegjshme sipas “Letrës standarde” të dërguar nga AK për arsye që sipas tyre nuk kemi prezantuar “Licencën për rërë dhe zhavore”, dhe nuk e kemi një katalog në gjuhën zyrtare të njërës nga prodhuesit.

Por kë këto sqarime ju kemi dërguar sipas kërkesës tuaj sipas nenit 72 të LPP-së për informacione shitesë dhe në përgjigjet tona të datës: 16.05.2018 i kemi cekur qartë përgjigjet tona, por po ju sqarojmë edhe një herë që: Kompania jonë ne dosjen e tenderit ka paraqitur: “Leje për aktivitete të veçanta” 524/KPMM/2017, “Leje për sortues” e datës 06.04.2018, nr.protokolli: 1228 me kohëzgjatje deri me datë: 26.03.2022, e cila përmbush kërkesat e licencës për rërë dhe zhavorre dhe këtë konfirmim e kemi marr edhe nga zyrtarët e KPMM-së

##### Përgjigje në pretendimin e parë ankimor

**Eksperti i OSHP-së** sqaron se ne dosjen e OE ankues gjindet LEJE PER AKTIVITETE TE VEÇANTA me nr.524/KPMM/2017 me afat te skadences 26.03.2018, e cila gjendet me emertimin LEJE për sortues me nr.protokolli 1228 e datës 06.04.2018.

Gjate rivleresimit nga AK te kerkohen informata sqaruese sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së.

##### Pretendimi pjesërisht i bazuar.

##### Përgjigje ne pretendimin e dyte ankimor

**Pretendimi i OE ankues se OE i propozuar për kontratë nuk e ka të plotësuar** Formularin e dorëzimit të tenderit nuk është plotësuar si duhet, pasi që vlefshmëria e tenderit është kërkuar që të jetë 90 ditë, kurse Operatori ekonomik fitues e ka shënuar 120 dite, e cila sipas Rregullores dhe Udhezuesit Operativ te Prokurimit Publik, konkretisht paragrafi 39.8 i kesaj rregullore tregon qarte ne tabele qe nese: “Formulari i Tenderit nuk eshte plotesuar si duhet apo mungon”, eshte “kusht administrativ” dhe thote qe “Refuzo tenderin pa kerkuar informacione te metejme”.; ndersa poashtu mungon edhe pjesa e dyte konkretisht identifikimi i operatorit ekonomik qe duhet nenshkruar dhe vulosur nga OE.

**Eksperti i OSHP-së** sqaron se Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar nuk e ka të plotësuar si duhet Formularin e Tenderit - Pjesa C, nuk qëndron për faktin se OE i rekomanduar në formularin C ka të plotësuar pikën 3 (çmimi total i tenderit) ku e ka vendosur **çmimin me shifra dhe fjalë**, në pikën 4 ku ne te OE e ka plotësuar **validiteti i tenderit**, në pikën 5 OE e ka plotësuar vlerën e sigurisë së ekzekutimit, në pikën 6 të Pjesës C ka shënuar emrin e OE dhe nacionalitetin, poashtu OE i propozuar ka plotësuar Identifikimin e Operatorit Ekonomik, që e ka plotësuar, nënshkruar dhe vulosur. Pra, të gjitha elementet që duhet të plotësohen OE i ka plotësuar edhe PJESEN C edhe Paramasen e ofertes, dhe te dy pjeset i ka te nenshkruara dhe vulosura siç kërkohen nga AK-ja.

**Ne RrUOPP neni 39 thotë :**

Formulari i tenderit nuk eshte plotesuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kerkuar informacion te me tejshem	Kusht administrativ
--	--	---------------------

**Bazuar në këtë kuptojmë se Nese nuk eshte plotesuar Formulari i Tenderit siç duhet apo mungon, AK mund ta refuzoj, por nga Formulari i plotesuar, nenshkruar dhe vulosur kuptojme se te gjitha pozicionet**

**qe kerkohen te plotesohen OE i rekomanduar i ka plotesuar.**

**Pra, nëse OE e ka plotesuar validitetin 120 dite, dhe validiteti i kerkuar nga AK eshte 90 dite, ky pretendim eshte i pabazuar.**

#### **Pretendimi i tretë ankimor**

Pretendimi i OE ankues se te OE i propozuar nuk eshte paraqitur garancioni i nënshkruar dhe i vulosur (origjinali) nga OE sic eshte kerkuar nga AK – “Garancioni i shkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik se merr pergjegjesi per sanimin ose nderrimin per te gjitha sherbimet, furnizmet dhe punet per projektin ne fjale minimum në afat prej 12 muaj pas pranimit teknik”.

#### **Përgjigje në pretendim ankimor**

Lidhur me pretendimin ankimor eksperti i OSHP-së, sqaron se nuk ka hasur në deklaratë të tillë per OE e rekomanduar.

**Pretendimi ankimor i bazuar.**

#### **Pretendimi i katërt ankimor**

Pretendimi i OE ankues lidhur me procedurën e vlerësimit të ofertave, ku raporti i vlerësimit te AK eshte nenshkruar nga dy(2) anetarë.

#### **Pergjigje në pretendimin ankimor**

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, se gjatë qasjes qe ka pasur OE ankues dhe sipas raportit te vlerësimit që ka përfunduar vlerësimin, vertetohet se ka pasur 23 oferta, ku nga këto oferta gjatë procedurës së vlerësimit vetëm 2 oferta ka shpallur të përgjegjshme AK-ja.

#### **Raporti i vlerësimit të AK-së:**

Komisioni i caktuar nga AK përbëhet nga:

Përfaqësuesi i MI caktohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet MI dhe Komunës së Gjakovës. Komisioni i vlerësimit ka konstatuar që në këtë aktivitet kanë ofertuar 23 OE (1 OE ka ofertuar në mënyrë elektronike dhe 22 në mënyrë fizike).

Pas vlerësimit të pjesës së parë me datë 11.05.2018 (e premte) përmes e-mailit kryetari i komisionit ka dorëzuar të dy anëtarët e komisionit raportin preliminar për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i qarkores së Gjakovës - LOT 1” (bashkangjitur mund të gjeni komunikimin zyrtar në dosjen e tenderit). Dhe ka kërkuar që anëtarët e komisioni ta analizojnë këtë raport dhe të japin sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Me datë 14.05.2018 (e hënë), pas shqyrtimit të draft-raportit dy anëtarët e komisionit nuk janë pajtuar me raportin preliminar për këtë aktivitet dhe përmes e-mailave zyrtar kanë sqaruar dhe kanë rekomandu:

6.Asnjë nga Operatorët nuk është i përgjegjshëm, apo i plotë me dokumente ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit;

7.Tetë(8) OE nuk janë të përgjegjshëm administrativisht, që do të thotë se eliminohen direkt. OE të eliminuar janë: Bejta, RSM, ARFA, Victory Com, Pevlaku, ALBA Construction, Berisha Com dhe Armendi.

8.Rekomandimi i dy anëtarëve të komisionit ka qenë, që të gjithë OE tjerë duhet kërkuar dokumentacion dhe sqarime shtesë, duke u bazuar në ligjin për prokurim publik neni 72;

9.Katër (4) OE që kryetari i komisionit që në raport i ka shpallur të përgjegjshëm, në mendimin e dy anëtarëve të komisionit kanë qenë të papranueshëm pasi që asnjëri nga ta nuk është i përgjegjshëm (sepse secilit i mungojnë dokumente të caktuara të cilët mund te ju kerkohen);

10.Rekomandimi i dy anëtarëve të komisionit ka qenë që raporti që ka dërguar kryetari i komisionit nuk mund të jetë raport final sepse si i tillë është në kundërshtim në mes të operatorëve të përgjegjshëm dhe operatorëve të papërgjegjshëm (bashkangjitur në dosjen e tenderit komunikimet zyrtare).

Pas analizimit të rekomandimeve nga anëtarët e komisionit menaxherja e prokurimit ka kërkuar që të respektohet neni 72 i LPP-së dhe të përgatiten të gjitha letrat standarde për OE të përgjegjshëm

administrativisht, duke mos përjashtuar respektimin e RrUOPP-së pika 39.1,39.2,39.4, 39.5,39.6,39.7,39.8 me datë 14.05.2018 të gjitha kërkesat për sqarime shtesë kanë qenë të përgatitura nga anëtarët e komisionit dhe po me atë datë janë dërguar 15 kërkesa për sqarime shtesë.

Me datë 17.05.2018 komisioni i vlerësimit ka filluar ekzaminimin e sqarimeve shtesë dhe ka përfunduar rekomandimet e tyre për këtë aktivitet me dt.25.05.2018.

Me datë 25.05.2018 kryetari i komisionit ka dorëzuar rekomandimin e tij të nënshkruar në zarfë përmes zyrës së arkivës së MI me shkresë zyrtare të protokolluar.

Rekomandimi përfundimtar i Kryetarit të komisionit ka qenë se nga 23 OE që kishin ofertuar në këtë aktivitet, vetëm 2 janë të përgjegjshëm:

1-Kag Asfalt shpk ne vlerë prej 2,649.075.00 €

2-NNTSH. "Drini Company" shpk me vlerë 2,995,589.38 €

Me datë 25.05.2018 dy anëtarët e tjerë të komisionit kanë dorëzuar edhe në mënyrë elektronike dhe në mënyrë fizike të nënshkruar rekomandimin e këtij aktiviteti, dhe rekoamdnimi i tyre ka qene se nga 23 OE qe kishin ofertuar ne kete aktivitet, vetem dy jane te pergjegjshem:

1-"4 AM" shpk me vlerë 2,618,594.85 euro

2-NNTSH. Drini Company me vlere 2,995,589.38 euro

Menaxherja e prokurimit pas shqyrtimit të rekomandimeve (njëri raport nga kryetari i komisionit – i nënshkruar vetëm nga kryesuesi, dhe raporti tjetër nga dy anëtarët, pasi që komisioni nuk është mbledh në mungesë të kryesuesit), shkresave të lëndës, shqyrtimit të ofertave dhe rekomandimet nga dy anëtarët e komisionit në bazë të nenit 40.13 të RrUOPP-së dhe neni 1 paragrafi 1 të LPP-së, duke e respektuar gjithë legjislacionin për prokurim publik në fuqi vendos që oferta e OE. "4-AM" shpk me vlerë 2,618,594.85 € ashtu sic është rekomanduar nga dy anëtarët e komisionit vlerësues, të shpërblehet me kontratë pasi që është oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët.

Të gjitha komunikimet zyrtare me anëtarët e komisionit gjenden në dosjen e tenderit.

Të gjitha letrat standarde për secilin OE veç e veç, dhe të gjitha rekomandimet e komisionit gjenden në dosjen e tenderit..

Eksperti i OSHP-së sqaron se raporti i vlerësimit është nënshkruar vetem nga dy anetar dhe jo nga kryesuesi i komisionit, siç po shihet nga komenti i komisionit del se komisioni ska qenë korrekt në kryerjen e detyrave që ju takon me ligj dhe kanë qenë favorizues të kompanive të ndryshme.

Pretendimi i OE ankues i bazuar.

### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të aprovohet të bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore),propozojme të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe të respektohen dispozitat ligjore.